

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XX, nr. 6030  
E shtunë, 6 qershor 2020  
çmimi 0.40 €

Takohen Thaçi me Metën dhe Ramën: Kosova dhe Shqipëria kanë qenë gjithmonë në krahë të njëra-tjetrës | FAQE 2



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

## ANALISTËT: QEVERIA HOTI DO TË JETË MË RACIONALE SE AJO KURTI



Njohësit e rrethanave politike, Faton Abdullahu dhe Shkëlzen Maliqi, kanë deklaruar për "Epokën e re" se qeveria Hoti pritet të jetë më e kujdesshme

për krijimin e një atmosfere të bashkëpunimit me shumë faktorë të brendshëm. Ata kanë bërë me dije se kjo qeveri nuk e ka luksin ta injorojë

opozitën. Sipas tyre, në aspektin e jashtëm sfida kryesore e qeverisë Hoti do të jetë dialogu për normalizim të marrëdhënieve Kosovë - Serbi | FAQE 4-5

## Miratohet programi qeverisës 2020-2023. Objektiva kryesore, pandemia dhe rimëkëmbja e ekonomisë



Programi qeverisës thuhet se është ndërtaur mbi prioritetet nacionale të Kosovës, i cili bazohet në vlerat demokratike, si: respekti për traditën, drejtësia, toleranca, përgjegjësia dhe transparenca, liria

individuale dhe kolektive. Objektiva themelore të qeverisë në këtë program 2020-2023 thuhet se janë betejat për ta mposhtur pandeminë Covid-19 dhe rimëkëmbja e ekonomisë

## ALI AHMETI THOTË SE ËSHTË KOHA PËR KRYEMINISTRIN E PARË SHQIPTAR NË MAQEDONINË E VËRIUT



### OPINION

#### DITË TË VËSHITURA PËR MBROJTJEN E MJEDISIT F. 11

Shkruan:  
Dr. sc. Ferat Shala



### AKTUALE

#### SELIMI: POLITIKA DUHET T'I MBAJË LARG DUART NGA DREJTËSIA F. 2

#### DHJETË AUTOAMBULANCA DHE 100 SHITËSË, NDIHMA E RADHËS E BE-së PËR KOSOVËN F. 7

### EKONOMI



#### ASK-ja: BIEN ÇMIMET E PRODHIMIT NË KOSOVË F. 9

#### OEK-u DHE USAID-i, MEMORANDUM BASHKËPUNIMI PËR FUQIZIMIN E DREJTËSISË KOMERCIALE F. 8

#### APROVOHET KËRKESA PËR RISHIKIMIN E BUXHETIT TË SHTETIT F. 8

### SPORT

#### SHABANI: NDAJ FLAMURTARIT, PËRVEÇ FITORES, ÇDO REZULTAT ËSHTË DËSHITIM F. 20

**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepcisht-Tetovë  
Curež-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
www.kolegijibiznesi.com  
info@kolegijibiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Pruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**DINO**  
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë  
tel & fax +381 38 566 666

# Takohen Thaçi me Metën dhe Ramën: Kosova dhe Shqipëria kanë qenë gjithmonë në krahë të njëra-tjetrës

**EPOKA ERE** Qendresa RAMA

TIRANË, 5 QERSHOR - Presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta, ka takuar të premten në Tiranë presidentin e Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi. Ai ka treguar se në këtë takim të dy kanë shprehur gatishmërinë për vazhdimin e bashkëpunimit mes dy vendeve. "Shprehëm gatishmërinë për vazhdimin e bashkëpunimit mes dy vendeve tona, me qëllim tejkallimin me

sukses të pasojave social-ekonomike të pandemisë Covid-19, kthimin në normalitet të jetës së qytetarëve dhe stabilizimin e plotë të lëvizjes së lirë të njerëzve dhe mallrave, veçanërisht me afrimin e sezonit veror turistik", ka thënë Meta pas takimit me Thaçin. Ai ka shtuar se është me rëndësi vazhdimi i dialogut Kosovë - Serbi për normalizimin përfundimtar të marrëdhënieve mes këtyre dy shteteve. Sipas presidentit Meta, ky dialog do të

garantojë jo vetëm njohje reciproke, por edhe të ardhmen e Kosovës dhe Serbisë në BE. "Bashkëjetesa midis shqiptarëve e serbëve është në interes të paqes, stabilitetit dhe perspektivës evropiane të rajonit tonë", është shprehur presidenti Meta.

Edhe presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka folur për takimin që ka pasur me presidentin e Shqipërisë, Ilir Meta. Ai ka bërë me dije se me Metën ka biseduar për rikthimin në normalitet të plotë të jetës së qytetarëve të dy shteteve tona. "Sa më shpejt që dy qeveritë e rifillojnë bashkëpunimin, aq më shpejt do t'i rimëkëmbim edhe ekonomitë e vendeve tona. Ne biseduam edhe për rëndësinë rifillimit të dialogut me Serbinë, i cili presim t'i përmbyllë të gjitha çështjet e hapura me Serbinë dhe të sjellë njohje reciproke ndërshtetërore. Kosova dhe Shqipëria kanë qenë gjithmonë në krahë të njëra-tjetrës dhe si të pandara duhet ta vazhdojnë rrugën e integritit euroatlantik", ka thënë Thaçi pas këtij takimi.



Pas takimit me Metën, presidenti Hashim Thaçi është prituri në takim edhe nga kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, i cili në llogarinë e vet në "Instagram" ka shkruar se me Thaçin ka pasur një bashkëbisedim vëllazëror. "Me presidentin e Kosovës, pas një bashkëbisedimi, si gjithnjë, vëllazëror", ka shkruar Rama. Presidenti Hashim Thaçi ka

thënë se Kosova dhe Shqipëria pa vonesa duhet t'i hapin kufijtë. "Me Edin, si çdoherë, pa protokoll, por bashkë për shqiptarët, Kosovën e Shqipërinë. Kosova dhe Shqipëria pa vonesa duhet t'i hapin tërësisht kufijtë dhe qytetarët tanë të lëvizin lirshëm kur të duan dhe kah të duan!", ka shkruar Thaçi në llogarinë e vet në "Facebook".



## Selimi: Politika duhet t'i mbajë larg duart nga drejtësia

**EPOKA ERE** F. DËRMAKU

PRISHTINË, 5 QERSHOR - Ceremonia e pranimit të detyrës së ministrit të Drejtësisë, Selim Selimi, është bërë nga sekretari i përgjithshëm i kësaj ministrie, Qemajl Marmullakaj, për shkak të mungesës së ish-ministres, Albulena Haxhiu.

Ministri Selimi u zotua se do të punojë dhe të angazhohet për përmbushjen e programit qeverisës që ka të bëjë me sundimin e ligjit, ndërsa tha se është e rëndësishme që politika

t'i ketë duart larg nga drejtësia. "Një pjesë e programit të qeverisë ka të bëjë me sundimin e ligjit. Ne do të angazhohemi dhe do të punojmë që ta bëjmë të realizueshëm këtë program. Është e rëndësishme që politika t'i ketë duart larg drejtësisë dhe mos të ndërtojë mekanizma që në ndonjë mënyrë mund të ndikojnë në prokurori dhe gjyqësi. Është e rëndësishme të ruhet edhe substanca e shërbimit civil në ministri, e cila e ka mbajtur ministrin të gjallë dhe të suksesshëm gjatë gjithë etapave", ka thënë ministri

Selimi.

Gjatë kësaj ceremonie ministri Selimi tha se nga sekretari i MD-së, Marmullakaj, është njoftuar për prioritetet e MD-së e që, sipas tij, kanë të bëjnë me agjendën legjislative si dhe disa çështje që janë në proces sipas planit të punës si dhe për disa çështje që kanë të bëjnë me sfida buxhetore. Ministri Selimi premtoi bashkëpunim me institucionet e drejtësisë, Kuvendin, shoqërinë civile dhe të gjithë aktorët e tjerë që kanë rol të rëndësishëm në përmirësimin dhe fuqizimin e sistemit të drejtësisë në vend.



## Edhe 15 raste të reja me Covid-19 në Shqipëri



Tiranë, 5 qershor - Ministria e Shëndetësisë në Shqipëri ka njoftuar se janë konfirmuar 15 raste të reja me Covid-19 gjatë 24 orëve të fundit. Dhjetë prej tyre janë në Tiranë, dy në Kamëz dhe

tre në Shkodër. Sipas Ministrisë së Shëndetësisë, dy rastet në Kamëz u konstatuan pozitive pasi kishin marrë pjesë në një ceremoni mortore. "Nga fillimi i epidemisë janë kryer mbi 17

500 teste molekulare dhe serologjike dhe janë konfirmuar pozitivë 1 212 raste, ndërsa rreth 75 për qind e të prekurve janë tashmë të shëruar. Në Laboratorin e Mikrobiologjisë në QSUT

janë kryer 2 035 teste serologjike në personel shëndetësor, me një pozitivitet të përgjithshëm rreth 7 për qind", ka njoftuar Ministria e Shëndetësisë në Shqipëri.

Qeveria e re e Kosovës ka mbajtur mbledhjen e parë

# Miratohet programi qeverisës 2020-2023, objektiva kryesore: pandemia dhe rimëkëmbja e ekonomisë



Me programin qeverisës 2020-2023, i cili ka marrë miratimin e kabinetit qeveritar në mbledhjen e së enjtes, qeveria Hoti zotohet se do të jetë mbrojtëse dhe zbatuese e të gjitha parimeve dhe normave që burojnë nga Kushtetuta e Kosovës. Programi qeverisës thuhet se është ndërtuar mbi prioritetet nacionale të Kosovës, i cili bazohet në vlerat demokratike, si: respekti për traditën, drejtësia, toleranca, përgjegjësia dhe transparenca, liria individuale dhe kolektive. Objektivat themelore të qeverisë në këtë program 2020-2023 thuhet se janë beteja për ta mposhtur pandeminë Covid-19 dhe rimëkëmbja e ekonomisë

rajon. Në këtë program theksohet se integrimi i vendit në Bashkimin Evropian dhe NATO do të jetë qëllimi nga i cili burojnë angazhimet institucionale për përparimin e demokracisë, ekonomisë dhe shtetit të së drejtës. Krahas këtyre objektivave, qeveria Hoti do të ketë prioritet: Forcimin e shtetit, avancimin e demokracisë, luftimin e dukurive negative, veçmas krimin dhe korrupsionit; Zhvillimin ekonomik bazuar në ekonominë e tregut, rritjen e punësimit dhe investimeve, për t'u përballur me pasojat e pandemisë dhe nevojën për fuqizim të aftësisë konkurruese të bizneseve e prodhimeve vendore; Marrjen e përgjegjësive për ta çuar përpara dialogun me Serbinë, në bashkëpunim me BE-në dhe SHBA-në, duke mos lejuar ndryshim të kufijve dhe shkëmbim të territorit; Avancimin e procesit të integritimit evropian, përmes zbatimit të MSA-së, si dhe procesit të integritimeve euroatlantike; Zbatimin e plotë të Agjendës së Reformave Evropiane; Krijimin e atmosferës së bashkëpunimit pozitivë-opozitë për çështjet vitale në interes të vendit dhe vendimmarrje në konsultim të gjerë dhe gjithëpërfshirëse, sidomos në procesin e dialogut me Serbinë. "Para vetes kemi agjendë të

ngjeshur. Programin qeverisës e kemi përmbledhur në disa objektiva qeverisëse: beteja që duhet ta fitojmë kundër pandemisë, rimëkëmbja ekonomike për ta kthyer standardin e jetës dhe nivelin e bizneseve aty ku ka qenë para pandemisë, derisa objektivat e tjera do të jenë forcimi i shtetit, avancimi i demokracisë, luftimi i dukurive negative, veçmas krimin dhe korrupsionit, zhvillimi ekonomik i bazuar në ekonominë e tregut me rritje të punësimit dhe investimit, si dhe marrja e plotë e përgjegjësive si qeveri në përputhje me Kushtetutën për ta çuar përpara dialogun me Serbinë në bashkëpunim të ngushtë me BE-në dhe ShBA-në duke mos lejuar ndryshim të kufijve dhe shkëmbim të territoreve dhe të tjera", ka thënë kryeministri Hoti. Hoti ka folur edhe për menaxhimin e Covid-19. "Masat gjatë fazës emergjente ku planifikojmë ta mbajmë të mobilizuar plotësisht sistemin tonë shëndetësor dhe vetëdijen e qytetarëve lart, ndërkohe që hapim bizneset dhe shoqërinë për t'u kthyer gradualisht në normalitet. Ndërmarrim protokollet që janë zhvilluar nga OBSH-ja dhe Komisioni Evropian për të bërë të mundur rikthimin gradual në normalitet. Masat afatgjata për përballjen me

pandeminë përfshijnë krijimin e kapaciteteve që të kryejmë numër shumë të madh të testeve në gjithë Kosovën me procedura të shpejta dhe të decentralizuara duke integruar të gjitha nivelet e sistemit shëndetësor, ashtu si edhe sistemin publik dhe privat shëndetësor që të kenë kapacitetet e nevojshme për përballjen në të ardhmen në rast se kthehet prapë pandemia", ka deklaruar kryeministri Hoti.

Po në këtë mbledhje qeveria ka miratuar vendimin për ndarjen e mjeteve për mbështetje financiare në vlerë prej 25 000.00 eurosh për ndihmë familjes së Agon Musliut që humbi jetën tragjikisht më 3 maj 2020 në Qendrën e Studentëve në Prishtinë e caktuar si hapësirë karantine.

Qeveria e Republikës së Kosovës ka miratuar edhe vendimin me të cilin i ka kërkuar Kuvendit të Republikës së Kosovës që ta bëjë ndryshimin dhe tejkalinimin e përkohshëm të rregullave fiskale të deficitit si dhe kufizimit të bilancit bankar të përdorshëm.

Tejkalimi, sipas këtij vendimi, rritet përkohësisht deri në tetë (8) për qind, ndërsa kufiri i bilancit të shfrytëzueshëm bankar ulët përkohësisht deri në tre (3) për qind. Kërkesa për këtë ndryshim bëhet pasi që Ligji për ndarjet buxhetore për vitin 2020 ndikohet nga situata e krijuar nga pandemia globale Covid-19.

**EPOKA  
ERE**

Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 5 QERSHOR - Qeveria e Republikës së Kosovës, e drejtuar nga kryeministri Avdullah Hoti, në mbledhjen e parë të mbajtur të enjten, pas asaj solemne, ka miratuar programin qeverisës 2020-2023, vendimin për ndarjen e mjeteve financiare për familjen e Agon Musliut dhe vendimin për t'i kërkuar Kuvendit të Kosovës që ta bëjë ndryshimin për tejkalinimin e përkohshëm të rregullave fiskale.

Me programin qeverisës 2020-2023, i cili ka marrë miratimin e kabinetit qeveritar në mbledhjen

e së enjtes, qeveria Hoti zotohet se do të jetë mbrojtëse dhe zbatuese e të gjitha parimeve dhe normave që burojnë nga Kushtetuta e Kosovës. Përparimi i lirive qytetare, mbrojtja e pronës private, promovimi i mundësive të barabarta, forcimi i ekonomisë së tregut, promovimi i drejtësisë efikase dhe asnjëse, do të jenë postulatet kryesore që do ta karakterizojnë ndërgjegjen politike të qeverisë së re. Gjithashtu, është thënë se do të promovohet përcaktimi strategjik i Republikës së Kosovës për forcimin e stabilitet në rajon, duke krijuar marrëdhënie të fqinjësisë së mirë me të gjitha shtetet në

ANALISTËT POLITIKË FLASIN PËR PRITJET DHE SFIDAT E QEVERISË SË RE

# ANALISTËT: QEVERIA HOTI DO TË JETË MË RACIONALE SE AJO KURTI



Njohësit e rrethanave politike, Faton Abdullahu dhe Shkëlzen Maliqi, kanë deklaruar për "Epokën e re" se qeveria Hoti pritet të jetë më e kujdesshme për krijimin e një atmosfere të bashkëpunimit me shumë faktorë të brendshëm. Ata kanë bërë me dije se kjo qeveri nuk e ka luksin ta injorojë opozitën. Sipas tyre, në aspektin e jashtëm sfida kryesore e qeverisë Hoti do të jetë dialogu për normalizim të marrëdhënieve Kosovë - Serbi

kjo nuk mund të thuhet me siguri, sepse këtë përçarje ka nxitur përbrenda qeverisë Kurti edhe LDK-ja. Nëse LDK-ja vazhdon të jetë e përçarë, kjo mangësi mund të reflektohet edhe në qeverisjen e saj dhe ta dëmtojë dhe ta bëjë edhe më të brishtë qeverinë Hoti", është shprehur Abdullahu.

Ndërsa analisti tjetër politik, Shkëlzen Maliqi, ka thënë se qeveria e re do të jetë më racionale se ajo e kaluara. Sipas tij, qeveria Hoti nuk e ka luksin ta injorojë opozitën. "Prej qeverisë Hoti mund të pritet që të jetë më racionale dhe e kujdesshme për krijimin e një atmosfere të bashkëpunimit me sa më shumë faktorë vendorë dhe që t'i largohet konfliktualitetit. Ajo nuk do ta ketë luksin e injorimit të opozitës. Të paktën duhet ta mobilizojë shumicën e deputetëve shqiptarë në mënyrë që vendimet e mëdha për vendin të mos sprovohen nga mazhoranca minimale që e ka mbështetur në aktin e krijimit të saj. Ajo duhet ta zbutë qëndrimin, nëse kjo është e mundur, edhe ndaj LV-së, duke mos mbajtur mëri dhe revanshizëm ndaj saj, kurse nuk duhet assesi ta largojë nga konsultimet dhe vendimmarrjet PDK-në", ka thënë Maliqi. Ai ka treguar se kjo qeveri duhet të merret me menaxhimin e

pandemisë dhe rimëkëmbjen ekonomike. "Një tjetër gjë që mund ta bëjë qeveria Hoti, edhe pse do ta ketë vështirë, është që të veprojë sa më mençur për tejkalimin e krizës ekonomike që e kërcënon vendin pas pandemisë. Ajo do të duhet të depolitizonte disa tema që në të kaluarën kanë krijuar paranoja dhe ndasi të ashpra politike. Këtu, para së gjithash, mendoj në masat ekonomike që do të mundësojnë rritjen e bashkëpunimit ekonomik rajonal dhe sidomos me Shqipërinë. Një tjetër gjë që mund të pritet nga qeveria Hoti është vazhdimi i luftimit të korrupsionit dhe krimit të organizuar", është shprehur ai.

## Qeveria e re duhet të ketë qasje tjetër ndaj dialogut me Serbinë

Njohësit e rrethanave politike kanë folur edhe për sfidat e jashtme që do t'i ketë qeveria e re. Sipas tyre, sfida kryesore e qeverisë Hoti në këtë drejtim do të jetë dialogu Kosovë - Serbi.

Analisti Faton Abdullahu ka thënë se kjo qeveri duhet të ketë një qasje tjetër ndaj dialogut Kosovë - Serbi. "Qeveria Hoti duket se do të ketë qasje krejt ndryshe nga ajo Kurti sa iu përket raporteve me ShBA-në.

Kjo qeveri do ta rikthejë Kosovën në agjendën e Uashingtonit zyrtar. Por, është herët të thuhet se kjo është predispozitë e mjaftueshme që të kemi sukses në dialog me Serbinë. Që të kemi sukses në dialog me Serbinë na duhet unitet e këtë është e vështirë ta ndërtojë qeveria Hoti. Ajo do të vazhdojë të mbetet qeveri shumë e brishtë. E keqja është se për shkak të kësaj brishtësie qeveria Hoti mund të vuajë nga mirëkuptimi i tepruar në raport me Serbinë. Nëse është kështu, ky do të jetë skaji tjetër, apo thënë ndryshe, ekstremi tjetër i qeverisë Kurti e cila ishte kryeneçe dhe jo kooperuese, as me ShBA-në", ka thënë ai.

Sipas Abdullahut, më mirë do të ishte që të shkohet në zgjedhje të reja në mënyrë që qytetarët të vendosin se kush duhet të përballet me Serbinë. "E mira e së mirës, nëse na premtton koha, pra nëse nuk do ta kemi interesin e gjeopolitikës euroatlantike që të hyjmë në dialog menjëherë, të shkojmë në zgjedhje pas kalimit të pandemisë. Thjesht, le ta përcaktojë votuesi kush duhet të përballet me Serbinë", është shprehur ai.

Kurse analisti tjetër Shkëlzen Maliqi ka thënë se për të qenë e suksesshme kjo qeveri në këtë proces nuk duhet t'u frikësohet kompromiseve. "Politikanët, por

**EPOKA E RE** **Muhamet KOCI**

**PRISHTINË, 5 QERSHOR** - Njohësit e rrethanave politike në vend kanë vlerësuar se qeveria Hoti nuk do ta ketë të lehtë qeverisjen. Faton Abdullahu dhe Shkëlzen Maliqi kanë deklaruar për "Epokën e re" se nuk duhet të kemi pritje të mëdha nga qeveria e re. Megjithatë, ata kanë thënë se qeveria Hoti do të jetë më racionale se qeveria Kurti si në aspektin e brendshëm, po ashtu edhe në atë të jashtëm. "Qeveria Hoti nuk e ka të vështirë të jetë më e mirë se Qeveria Kurti, por e ka gati të pamundur të jetë e mirë, përkatësisht efikase dhe të ofroj zhvillim e ta rrisë kualitetin e jetës së qytetarëve tanë. Ajo është shumë e brishtë për të qëndruar vertikalisht e për të shtyrë projekte përpara. Ajo do të

qeverisë gjithmonë në zgrip të ekzistencës, sepse mezi siguron 61 vota, me çka ka lënë shumicën shqiptare jashtë, krejt PDK-në dhe LV-në. Për më shumë, ajo do të varet shumë edhe nga Lista Serbe. E kjo Listë, nëse hyjmë në dialog me Serbinë, do të jetë zezdita e kësaj qeverie dhe jo vetëm", ka deklaruar analisti politik Faton Abdullahu.

Ai ka thënë se kjo qeveri do të jetë më unike se qeveria Kurti, duke shtuar se i duhet bashkëpunim me partitë opozitare. "Qeveria Hoti, që të mos jetë qeveri koti, duhet ta ketë ndihmën e ShBA-së dhe BE-së më shumë se cilado qeveri tjetër dhe duhet ta ketë mirëkuptimin ekstra të madh të opozitës, pra të PDK-së dhe LV-së. Qeveria Hoti nuk do të jetë e përçarë sa ishte ajo e Kurtit, por

edhe opinioni në Kosovë, nuk janë të vetëdijshëm se ne jemi në epiqendër të një procesi ku, përkundër kontradiktave dhe mospajtimeve që kanë mes vete, BE-ja dhe ShBA-ja janë jetësisht të interesuara që Ballkanin Perëndimor ta largojnë nga sfera e influencës të Rusisë. Ajo që te ne perceptohet shpesh si favorizim i Serbisë karshi Kosovës, p. sh., kur BE-ja dhe ShBA-ja insistojnë që ta heqim taksën dhe reciprocitetin ndaj Serbisë, nuk është në funksion të dëmtimit të Kosovës si shtet sovran, por një veprim i përkohshëm që lehtëson vazhdimin e dialogut, që tani ka gjasa të shndërrohet në negociata finale politike për marrëveshje historike, që Kosovës duhet t'ia sigurojë anëtarësimin në OKB, ka thënë Maliqi, duke shtuar se qeveria e re duhet të jetë racionale në këtë proces. "Në këtë aspekt ne duhet të jemi racionale dhe jo paranojakë dhe refuzues ndaj kompromiseve (do t'i quaja të buta) për të cilat do të duhej të vendosim, nëse alternativa për këto kompromise do të ishte mbetja në një pozitë siç jemi sot, pa njohje universale ndërkombëtare. Ky do të jetë sovranitet i Kosovës dhe jo kjo që kemi sot", është shprehur Maliqi.

ShBA-ja dhe BE-ja kanë mirëpritur formimin e qeverisë së re. Në urimet e tyre për kryeministrin Avdullah Hoti, ShBA-ja dhe BE-ja kanë vlerësuar se mezi presin të bashkëpunojnë me qeverinë e re për rifillimin e dialogut Kosovë - Serbi. "Ne e mirëpresim formimin e qeverisë së re dhe mezi presim të bashkëpunojmë për vazhdimin e dialogut me Serbinë", është thënë në deklaratën e të dërguarit të posaçëm të Shteteve të Bashkuara për dialogun Kosovë - Serbi, Richard Grenell. Kurse BE-ja ka vlerësuar se një rifillim i shpejtë i dialogut Beograd - Prishtinë, i lehtësuar nga BE-ja, është thelbësor për të arritur një normalizim gjithëpërfshirës të marrëdhënieve me Serbinë.

# Ali Ahmeti thotë se është koha për kryeministrin e parë shqiptar në Maqedoninë e Veriut

SHKUP, 5 QERSHOR - Bashkimi Demokratik për Integrim (BDI), i cili drejtohet nga Ali Ahmeti, ka shënuar 18-vjetorin e themelimit si subjekti më i madh i shqiptarëve në Maqedoni.

Ali Ahmeti ka thënë se BDI-ja është trashëgimtare e Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare dhe përfaqësuese legjitime dhe absolute e vullnetit politik të shqiptarëve në dy dekadat e fundit. "Me kënaqësi të madhe dhe krenari për veprimtarinë tonë të përbashkët, ju uroj këtë 18-vjetor të themelimit të Bashkimit Demokratik për Integrim, në veçanti të gjithë anëtarëve, bashkëdrejtuesve, aktivistëve, përkrahësve, simpatizantëve, votuesve, bashkëveprimtarëve, aleatëve, por edhe të gjithë qytetarëve të vendit. 18 vjet qëndruam bashkë në çdo sfidë me të cilën u ballafaquam, në procese të panumërta për ta arritur barazinë e plotë, për t'u integruar tërësisht në NATO dhe në Bashkimin Evropian, për ta rritur cilësinë e jetës, për të siguruar të ardhmen e rinisë sonë dhe të të gjithë neve", ka thënë Ahmeti në deklaratën e tij për media.

Ai ka thënë se sot Maqedonia është anëtare fuqplotë e aleancës më të madhe politiko-ushtarake në botë - NATO-s. "Sot jemi vend që negocion me Bashkimin Evropian për anëtarësim të plotë në familjen e madhe të kontinentit tonë. Sot jemi me barazi të plotë gjuhësore dhe me zbatim të plotë të pjesës normative të Marrëveshjes së Ohrit, me tre universitete në gjuhën shqipe, me shkolla, spitale, çerdhe, rrugë, institucione. Sot instalojmë parimin e konsensualitetit edhe në vendimmarrje, edhe në përzg-



jedhje si dhe drejtuar si shqiptarë dhe qytetarë të këtij vendi Kuvendin, ministrinë e Mbrojtjes dhe të Punëve të Brendshme, Avokatin e Popullit dhe të Shtetit, Gjykatën Supreme dhe Kushtetuese, por akoma nuk është përmbyllur e gjitha, prandaj ka ardhur koha për diçka të madhe. Të gjitha këto i mundësoi besimi juaj i palëkundur në të gjitha proceset zgjedhore, parlamentare, lokale, presidenciale, referendume gjatë 18 vjetëve që nga 5 qershori i vitit 2002", është shprehur Ahmeti.

Ai ka shtuar se ky përvjetor i BDI-së i gjen në kohë pandemie, e cila ka marrë aq shumë jetë dhe ka prekur miliona njerëz, duke mos e përjashtuar as Maqedoninë e

Veriut. "Ne të gjithë bashkërisht jemi në këtë betejë, pa dallime etnike, kulturore, fetare, shtetërore, prandaj bashkë dhe pa asnjë përjashtim duhet t'i përmbahemi dhe t'i respektojmë masat e kujdesit në mënyrë që t'i kthehemi normalitetit dhe jetës së përditshme", është shprehur Ahmeti.

Lideri i BDI-së ka theksuar se në përvjetorin e 18-të të kësaj partie kanë më shumë nevojë se çdoherë për njëri-tjetrin, për solidaritetin brenda organizatës, për shtrirjen e dorës së bashkëpunimit dhe mbështetjes. "Për besimin që do t'ia dalim sepse diçka e madhe po vjen para nesh, diçka që do të kërkojë kontributin e gjithsecilit prej nesh. Të dashur qytetarë, ne e nisëm

bashkë këtë rrugëtim para 18 vjetëve, bashkë u përballuam me çdo sfidë dhe i besuam njëri-tjetrit. Bashkë i përcaktuam dhe i realizuam synimet tona dhe në këtë përvjetor kaq të rëndësishëm për të gjithë ne, le ta përcaktojmë bashkërisht edhe qëllimin tonë të radhës që në zgjedhjet që pasojnë, ta realizojmë synimin për të zgjedhur një personalitet të vlerësuar, të dëshmuar dhe të pranueshëm të cilin ose të cilën do ta përzgjedhim bashkërisht për kryeministrin e parë shqiptar. Në çdo përvjetor përcaktojmë synime ambicioze dhe me kohë, ato i realizojmë, prandaj gëzuar miq dhe na pritë e mbara drejt realizimit të qëllimeve tona të përbashkëta!", ka thënë Ali Ahmeti.

## Ambasadori amerikan takohet me Hotin dhe Osmanin

PRISHTINË, 5 QERSHOR (ER) - Kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, ka pritur të premten në një takim njoftues ambasadorin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA) në Kosovë, Philip S. Kosnett. Gjatë këtij takimi kryeministri Hoti e ka falënderuar ambasadorin Kosnett për mbështetjen e përhershme të ShBA-së për vendin, duke pohuar vendosmërinë e Qeverisë së Kosovës për të punuar ngushtë me Amerikën edhe në të ardhmen. Në këtë

takim, kryeministri Hoti e ka njoftuar ambasadorin amerikan për prioritetet e menjëhershme të qeverisë së re siç janë: lufta kundër Covid-19 dhe rimëkëmbja ekonomike. Hoti ka thënë se prioritetet e tjera do të jenë forcimi i shtetit, avancimi i demokracisë, luftimi i korrupsionit, rritja e punësimit, zhvillimi i tregut të lirë dhe marrja e përgjegjësisë për dialogun. Kurse ambasadori Kosnett ka deklaruar se Shtetet e Bashkuara do ta

vazhdojnë mbështetjen e saj për Kosovën, sidomos në përpjekjet për t'i përmirësuar marrëdhëniet rajonale, mbështetjen e zhvillimit ekonomik dhe forcimin e sundimit të ligjit, përfshirë këtu edhe luftën kundër korrupsionit. Ambasadori amerikan të premten është takuar edhe me kryetaren e Kuvendit, Vjosa Osmani, me të cilën ka biseduar për agjendën e legjislativit si dhe për urgjencën e ratifikimit të disa marrëveshjeve ndërkombëtare



## Ministrja e Jashtme, Meliza Haradinaj Stublla, nderon "Heroinat"

PRISHTINË, 5 QERSHOR (ER) - Ministrja e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, Meliza Haradinaj-Stublla, të premtën edhe zyrtarisht ka marrë detyrën e shefes së diplomacisë së Republikës së Kosovës. Para se të merrte detyrën e saj të re, ministrja Haradinaj-Stublla ka bërë nderime te memoriali "Heroinat", i ndërtuar për të kujtuar rreth 20 000 viktimë të dhunës seksuale gjatë luftës së fundit në Kosovë. Shefja e diplomacisë së

Kosovës ka thënë se jorastësisht ka vizituar këtë memorial. Ajo ka treguar se të vërtetën e plotë për Kosovën dhe popullin e saj do ta thotë gjithmonë zëshëm, kudo që të shkojë nëpër botë. "Këtu zotohem se do të kërkoj zëshëm drejtësi për gjithçka që ka ndodhur. Drejtësia dhe përgjegjësia për plagët tona ende të hapura do të kërkojmë pa ndalur", ka thënë ministrja Haradinaj - Stublla.

Pas nderimeve të bëra te

memoriali "Heroinat", përpara ministrisë, ministrja Haradinaj-Stublla është prituar nga u. d. sekretari i përgjithshëm, Skënder Durmishi, drejtori i përgjithshëm Albert Prenkaj dhe udhëheqës të departamenteve dhe divizioneve të këtij institucioni.

Ministrja Haradinaj-Stublla, pasi ka marrë detyrën zyrtarisht, ka vizituar nëpër zyra edhe stafin e ministrisë që do ta udhëheqë.



## Bërnabiq: Nuk kam informacione se Serbia ka ndaluar fushatën kundër Kosovës

PRISHTINË, 5 QERSHOR - Kryeministrja e Serbisë, Ana Bërnabiq, ka thënë se nuk ka informacione se vendi i saj ka ndaluar fushatën e tërheqjeve të njohjeve të Kosovës.

Të enjten burime diplomatike në Bruksel u kanë thënë gazetarëve se Serbia ka pranuar ta pezullojë fushatën e çnjohjeve të Kosovës "për t'i kontribuar atmosferës për rinisjen e dialogut për normalizim marrëdhëniesh" midis Prishtinës dhe Beogradit. "E kam parë këtë lajm, por jo edhe burimin e këtij lajmi. Kur flisni për lajm nga Brukseli, unë nuk e di se çfarë do të thotë. A vjen nga



Komisioni Evropian, nga Parlamenti Evropian, apo e ka thënë ndonjë njeri në rrugë dhe ne e marrim atë si burim të

ligjshëm", tha Bërnabiq për Shërbimin e Ballkanit të Radios Evropa e Lirë. "Ju kërkon nga unë të komentoj lajme jozyrtare,

që janë publikuar në mënyrë tendencioze dhe në kohë tendencioze", ka shtuar Bërnabiq.

Ajo ka thënë se e përsërit qëndrimin e presidentit të Serbisë, Aleksandar Vuçiq, dhe "qëndrimin e shtetit" se Serbia gjatë dialogut "mund t'i pezullojë bisedimet me shtetet e tjera që mendojnë se kanë gabuar me njohjen e pavarësisë së njëanshme të Kosovës, nëse Prishtina i pezullon bisedimet e saj për të arritur njohje të reja dhe për t'u bërë anëtare e organizatave ndërkombëtare". "Mendojmë se kjo është e drejtë. Gjatë dialogut pezullohet

gjithçka derisa të përpiqemi të gjejmë një zgjidhje kompromisi", ka thënë Bërnabiq.

Edhe ministri i Jashtëm serb, Ivica Dačić, ka mohuar të enjten se Serbia ka ndaluar fushatën e tërheqjeve të njohjeve të pavarësisë së Kosovës.

Zyrtarët serbë nuk e kanë fshehur se diplomacia e tyre udhëhiqet në këtë drejtim. Megjithatë, numri i vendeve që e kanë tërhequr njohjen e pavarësisë së Kosovës - e cila është shpallur në vitin 2008 - si rezultat i përpjekjeve diplomatike të Serbisë, nuk është i qartë.

## Me moton "Koha për natyrën", AMMK-ja shënoi Ditën Botërore të Mjedisit

PRISHTINË, 5 QERSHOR (ER) - Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës, përmes Drejtorisë për Administrimin e Parkut Kombëtarë "Sharri" dhe në bashkëpunim me organizatën WWF zyra në Prishtinë, ka shënuar të enjten 5 Qershorin - Ditën Botërore të Mjedisit.

Aktiviteti kryesor është zhvilluar në zonën turistike të Prevallës, në rrugën Prevallë - Brezovicë, ku është ndërmarrë aksion për pastrim të mbeturinave përgjatë rrugës dhe rrjedhës së lumit si dhe ecje në natyrë deri te lokacioni Burimi i Madh, i njohur ndryshe si Shtëpia e Vëzhguesve. Dita Botërore e Mjedisit këtë vit

është shënuar me temën "Koha për natyrën". Duke e ditur faktin se të gjitha të mirat materiale, ushqimi, ajri që thithim, uji që pimë dhe klima që na rrethon vijnë nga natyra, kjo moto ka për synim të nxisë aktivitete që promovojnë mbrojtjen e natyrës dhe rolin e saj për mirëqenien dhe shëndetin publik.

Aktiviteti është organizuar pikërisht në Parkun Kombëtar "Sharri", me moton "Parqet për shëndetin - parqe të shëndetshme, njerëz të shëndetshëm", duke e ditur rëndësinë që kanë parqet kombëtare për mbrojtjen e natyrës.



## Lutfi Haziri kërkon zbardhjen e vrasjes së gazetarit Bardhyl Ajeti



GJILAN, 5 QERSHOR (ER) - Kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, në 15-vjetorin e vrasjes së gazetarit dhe publicistit Bardhyl Ajeti, ka kërkuar zbardhjen e rastit dhe autorët ta marrin dënimin e merituar. Kryetari Haziri e ka vlerësuar lart Ajetin

për guximin dhe profesionalizmin e tij, duke shtuar se shpirti i tij nuk prehet në paqe përderisa nuk janë zbuluar autorët e vrasjes. "Sot e asaj dite vrasja e tij mbetet enigmë. Kërkoj nga organet e shtetit që ta zbardhin sa më parë këtë dhe vrasjet e tjera dhe

autorët ta marrin dënimin merituar. Veç në këtë mënyrë eshtrat e Bardhytit dhe të tjerëve do të pushojnë të qetë. Bardhylin do ta kujtojmë përgjithmonë për guximin dhe kontributin e tij të madh në gazetari e publicistikë", ka thënë Haziri.

Bashkimi Evropian (BE) vazhdon donacionet dhe mbështetjen për shëndetësinë

## Dhjetë autoambulanca dhe 100 shtretër, ndihma e radhës e BE-së për Kosovën

Në kuadër të fazës së tretë të shpërndarjes së donacionit, si mbështetje për parandalim dhe mbrojtje nga Covid-19, Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (ShSKUK) ka pranuar nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë dhjetë autoambulanca, 100 shtretër dhe pajisje të tjera



**EPOKA E RE** **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 5 QERSHOR - Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (ShSKUK) ka pranuar të premtën kontingjentin e tretë të pajisjeve mbrojtëse nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë në vlerë prej 5 milionë eurove. Kjo mbështetje vjen në kuadër të fazës së tretë të shpërndarjes së donacionit si mbështetje për parandalim dhe mbrojtje nga Covid-19.

Në ceremoninë e dorëzimit-pranimit të donacionit morën pjesë Armend Zemaj, ministër i Shëndetësisë, Basri Sejdiu, drejtor i përgjithshëm i ShSKUK-së, zyrtarë të BE-së në Kosovë, por edhe mjekë dhe përfaqësues nga Organizata Botërore e Shëndetësisë dhe institucionet e

tjera relevante. Në donacion përfshihen dhjetë autoambulanca, 100 shtretër dhe pajisje të tjera.

Me këtë rast, ministri i Shëndetësisë, Armend Zemaj, ka falënderuar BE-në për këtë donacion, duke shprehur se bashkëpunimi do të vazhdojë dhe do të ketë edhe donacione të tjera.

Drejtori i ShSKUK-së, Basri Sejdiu, ka thënë se këto 10 autoambulanca janë të mirëpritura dhe do të ndihmojnë në lehtësimin e punës së profesionistëve shëndetësorë. Sipas tij, ky donacion vjen në kohën më të duhur dhe shumë të nevojshme. Samir Selimi, menaxher i projektit në Zyrën e BE-së, ka pohuar se ky donacion është në vazhdim të ndihmës që BE-ja po i

jep Kosovës në luftën ndaj pandemisë.

Në prill dhe maj Bashkimi Evropian ka dërguar edhe disa furnizime të tjera në Kosovë, përfshirë: doreza, maska, syze, dezinfektues e të tjera. "Jam e lumtur që kemi një shpërndarje tjetër të pajisjeve mjekësore në sektorin e shëndetësisë në Kosovë, të cilat jemi të sigurt se do t'u shërbejnë qytetarëve në

Kosovë si gjatë pandemisë COVID-19, po ashtu edhe në vitet në vazhdim", ka pohuar të premtën Nataliya Apostolova, shefe e Zyrës së BE-së dhe përfaqësuese e posaçme e BE-së në Kosovë.

Ajo ka bërë me dije se brenda disa javëve të ardhshme presin të ofrojnë 30 ventilatorë të njësisë së kujdesit intensiv. "Gjithashtu, edhe pajisje shtesë mjekësore,

më shumë shtretër spitalorë dhe 6 000 teste për Covid-19, me të cilat do të përmbillen dërgesat e planifikuara të pajisjeve mjekësore, në vlerë prej 5 milionë eurosh, të dhuruara nga Bashkimi Evropian", ka deklaruar Apostolova. Ajo i lavdëroi autoritetet e Kosovës, stafin mjekësor dhe stafin laboratorik për punën gjatë pandemisë.

## Avokati i Popullit bën thirrje për mbrojtjen e ambientit

**EPOKA E RE** **Qendresa RAMA**

PRISHTINË, 5 QERSHOR - Avokati Popullit, Hilmi Jashari, me rastin e shënimit të Ditës Botërore të Mjedisit, ka tërhequr vëmendjen e të gjitha institucioneve në vend për nevojën e angazhimit më të thelluar për ndërmarrjen e masave konkrete dhe të nevojshme për mbrojtjen dhe ruajtjen nga degradimi i mjedisit në vend në mënyrë që të respektohet e drejta e qytetarëve për mjedis të sigurt dhe të shëndetshëm. "Në këto ditë të vështira, kur i gjithë globi është përballur me situatën e krijuar nga pandemia Covid-19, është vënë në pah roli i madh i natyrës dhe shqetësimi i madh mbarëbotëror për mbrojtjen e saj. Vendin tonë vazhdojnë ta sfidojnë çështjet e mëdha të ambientit si problemet e ujit, ajrit dhe tokës, menaxhimit të mbeturinave, kontrollimit të zhurmës dhe të gjitha këto probleme mjedisore mbeten pothuajse në fazë të njëjtë përgjatë viteve. Gjithashtu, nuk është arritur ndonjë përmirësim



në zbatimin e legjislativës mjedisore si dhe mbrojtjes së të drejtave mjedisore në gjykatë. Respektimi i së drejtës së publikut për qasje në informata mjedisore dhe pjesëmarrje në proceset vendimmarrëse lidhur me mjedisin vazhdon të përcillet

me paqartësi dhe sfida", ka thënë Jashari.

Duke pasur në konsideratë se e drejta për mjedis të sigurt dhe të shëndetshëm është e garantuar me Kushtetutën e vendit dhe, si e tillë, është e renditur ndër vlerat në të cilat bazohet rendi

kushtetues, Avokati i Popullit fton institucionet e vendit, veçanërisht Kuvendin e Kosovës, që të ushtrojë kontrolle efektive lidhur me zbatimin e standardeve dhe legjislativës mjedisore nga ana e qeverisë së vendit.

Gjithashtu, ai u ka bërë thirrje edhe organeve të pushtetit gjyqësor që të ofrojnë mbrojtje efektive gjyqësore qytetarëve lidhur me trajtimin e rasteve të iniciuara në gjykatë për cenim të të drejtave mjedisore.

Kohët e fundit Avokati i Popullit ka qenë i angazhuar për trajtimin e çështjeve të mjedisit në vend, duke nxjerrë raporte me rekomandime në shumë fusha lidhur me kufizimin e së drejtës për mjedis të sigurt e të shëndetshëm si në rastin e mbeturinave me përmbajtje të asbestit, çështja e hidrocentraleve nëpër lumenjtë e vendit dhe shumë çështje të tjera.

Dita Botërore e Mjedisit, e cila është përcaktuar nga Asambleja e Përgjithshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuara në vitin 1972, festohet më 5 qershor. Tema e sivjetme është "Festo biodiversitetin" dhe ka për qëllim rritjen e ndërgjegjësimit për mbrojtjen e mjedisit dhe, po ashtu, një vëmendje do t'i kushtohet edhe rizikut të zhdukjes së një milion specieve anembanë botë.

## Aprovohet kërkesa për rishikimin e buxhetit të shtetit

PRISHTINË, 5 QERSHOR (ER) - Qeveria e re e Kosovës ka miratuar kërkesën për shqyrtimin e propozim-vendimit për të kërkuar nga Kuvendi ta bëjë ndryshimin e përkohshëm të rregullave fiskale të deficitit si dhe kufizimit të bilancit bankar të

përkohshëm. Këtë kërkesë e ka bërë ministrja e Financave dhe Transfereve, Hykmete Bajrami dhe është aprovuar në mbledhjen e kabinetit qeveritar, të drejtuar nga kryeministri Avdullah Hoti. "Ministria e Financave dhe Transfereve propozon rishikimin e

rregullave fiskale që në këtë kohë llogaritet të jenë kufizime buxhetore për këtë situatë, marrë parasysh që parametrat makro-fiskalë të paraqitur për ndarjen buxhetore për vitin 2020 ndikohen nga situata me Covid-19. Nevojiten të ndryshohen

përkohësisht disa rregulla fiskale për menaxhimin e financave. Andaj, propozoj të aprovohet ndryshimi i përkohshëm i kufirit të deficitit në nivelin deri në 6.5 për qind të bruto-produktit të propozuar. Kërkohe të bëhet ndryshimi i përkohshëm i rreg-



ullave fiskale të deficitit si dhe kufizimi i bilancit bankar dhe i njëjti duhet të miratohet nga Kuvendi", ka thënë Bajrami.

## OEK-u dhe USAID-i nënshkruajnë memorandum për fuqizimin e drejtësisë komerciale

Oda Ekonomike e Kosovës dhe USAID-i kanë nënshkruar të premtën një memorandum bashkëpunimi, me anë të të cilit synojnë fuqizimin e drejtësisë komerciale në vendin tonë. Me këtë rast, kryetari i OEK-ut, Berat Rukiqi, ka thënë se ky memorandum është arritur në kuadër të lehtësimit të kushteve të të bërit biznes në Kosovë. Kurse Christopher Thompson, drejtues i projektit të USAID-it për drejtësi komerciale, ka theksuar rëndësinë e bashkëpunimit me Odën Ekonomike të Kosovës (OEK) si një ndër partnerët kyç për zhvillimin e mëtejshëm të drejtësisë komerciale, në shërbim të qasjes më të mirë dhe efikase në drejtësi për bizneset



përdorimit të metodave alternative të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve siç janë arbitrazhi dhe ndërmjetësimi dhe kuptimi më i mirë i legjislacionit komercial. "Ky memorandum i bashkëpunimit bazohet në parimet e koordinimit të mirë dhe angazhimit të sektorit privat për përmirësimin e drejtësisë komerciale. Bashkëpunimi synohet përmes shkëmbimit të informacioneve, organizimit më të mirë të aktiviteteve në lidhje

me promovimin e arbitrazhit, mbledhjen e të dhënave, statistikave, vlerësimeve dhe aktiviteteve të tjera të ndërlidhura. Ky bashkëpunim ka për qëllim edhe ofrimin e ndihmës lidhur me ligjet dhe politikat që prekin bizneset dhe angazhimit aktiv të sektorit privat në dialog për përmirësimin e drejtësisë komerciale. Mes të tjerash, synohet të organizohen tryeza, seminare, takime e iniciativa të ndryshme si dhe vizita të ekspertëve nga të dyja

palët", ka njoftuar OEK-u. Me rastin e nënshkrimit të këtij memorandum, kryetari i OEK-ut, Berat Rukiqi, ka thënë se kjo ujdë konkretizohet pas një komunikimi të vazhdueshëm dypalësh në mes të institucioneve repektive, rrjedhimisht kulmon me bazat e bashkëpunimit në mes të sektorit privat të përfaqësuar nga Oda Ekonomike e Kosovës dhe projektit të USAID-it për drejtësi komerciale. Më tutje, Rukiqi ka thënë se ky memorandum është në kuadër të lehtësimit të kushteve të të bërit biznes në vend, sidomos te pjesa që ka më shumë probleme, pjesa e sundimit të ligjit dhe efikasitetit të sistemit gjyqësor. Kurse Christopher Thompson, drejtues i projektit të USAID-it për drejtësi komerciale, ka theksuar rëndësinë e bashkëpunimit me Odën Ekonomike të Kosovës (OEK), si një ndër partnerët kyç në zhvillimin e mëtejshëm të drejtësisë komerciale në shërbim të qasjes më të mirë dhe efikase në drejtësi për bizneset.

**EPOKA E RE** Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 5 QERSHOR (ER) - Oda Ekonomike e Kosovës bashkë me projektin e USAID-it për drejtësi komerciale kanë nënshkruar një memorandum bashkëpunimi në funksion të forcimit të

bashkëpunimit midis palëve në fushat me interes të përbashkët. Objektivat kryesore të këtij memorandumit përfshijnë bashkëpunimin midis dy palëve me qëllim të mbështetjes së Odës Ekonomike të Kosovës për ta zhvilluar më tutje punën drejt ndërgjegjësimit, efikasitetit dhe

## Hoti i jep mbështetje Ministrisë së Financave për rimëkëmbjen ekonomike

PRISHTINË, 5 QERSHOR (ER) - Ministrja e Financave dhe Transfereve (MFT), Hykmete Bajrami, ka pritur të premtën në takim kryeministrin e Republikës së Kosovës, Avdullah Hoti. Gjatë këtij takimi është diskutuar për gjendjen aktuale financiare, për të hyrat nga Dogana dhe ATK-ja për situatën e krijuar nga pandemia Covid-19 si dhe ndikimin e pandemisë në buxhetin e Kosovës. Ministrja Bajrami ka theksuar se fillimi i përgatitjes së rishikimit të buxhetit, ndihma dhe përkrahja ndaj sektorit privat si dhe përfshirja e tyre në pakon për rimëkëmbjen ekonomike do

të jenë hapat e parë që do t'i ndërmarrë si ministre e Financave dhe Transfereve. Ndërsa kryeministri Avdullah Hoti ka shprehur përkrahjen për Ministrinë e Financave dhe Transfereve, duke shtuar se në programin e qeverisë vend të veçantë do të kenë zhvillimi ekonomik dhe përmirësimi i jetës së qytetarëve. Gjithashtu, Hoti ka thënë se rishikimi i buxhetit kërkon një bashkëpunim ndër-institucional sepse gjendja e krijuar nga pandemia Covid-19 ka shkaktuar shpenzime shtesë të paparashikuara për buxhetin e Kosovës.



## Kuçi pranon detyrën e ministrit të Zhvillimit Ekonomik dhe Ambientit

PRISHTINË, 5 QERSHOR (ER) - Blerim Kuçi ka pranuar detyrën e ministrit të Ambientit nga ish-ministri i Infrastrukturës dhe Ambientit, Lumir

Abdixhiku. Ky i fundit e ka informuar Kuçin lidhur me ecurinë e projekteve që janë duke u realizuar, për investimet ndërkombëtare që janë gati për

të filluar implementimin, për arritjet, sfidat dhe për tema të tjera me rëndësi në fushat që mbulohe nga ky dikaster. Ndërsa ministri Blerim Kuçi e

ka falënderuar Abdixhikun për punën e mirë të udhëheqjes së këtij dikasteri dhe ka shprehur vendosmërinë për realizimin e punëve të mira edhe më tutje.





# ASK-ja: Bien çmimet e prodhimit në Kosovë

Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) ka bërë me dije se gjatë tremujorit të parë të këtij viti kanë rënë çmimet e prodhimit në vendin tonë. Sipas ASK-së, prodhimi ka pësuar rënie prej 0.3 përqindësh. ASK-ja ka theksuar se rëniet më të mëdha kanë ndodhur në prodhimin e makinerisë dhe pajisjeve të ndryshme. Kjo agjenci ka treguar se gjatë këtij tremujori ka pasur rënie të madhe edhe në nxjerrjen e xehes dhe metalit

**EPOKA ERE** Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 5 QERSHOR (ER) - Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) ka publikuar Indeksin e Çmimeve të Prodhimit për tremujorin e parë (TM1) të vitit 2020. Indeksi i tërësishëm i çmimeve të prodhimit në Kosovë ka pësuar rënie për 0.3 për qind ndërmjet TM4 të vitit 2019 dhe TM1 të vitit 2020. "Rënie më të mëdha sipas degëve të veprimtarive ekonomike vërehen te: prodhimi i mobilieve (-4.6 për qind); prodhimi i makinerisë dhe pajisjeve p.k.t. (-4.6 për qind); prodhimi i produkteve minerale jometalike (-4.5 për qind); prodhimi i pijeve (-2.0 për qind); prodhimi i mjeteve motorike të transportit, rimorkiove dhe gjysmë rimorkiove (-2.0 për qind); prodhimi i drurit dhe i produkteve të drurit dhe të tapës, përveç mobilieve: prodhimi i artikujve nga kashta

dhe materialeve të gërshetuara-thurëse (-1.4 për qind); prodhimi i letrës dhe produkteve prej saj (-1.4 për qind); prodhimi i produkteve të gomës dhe të plastikës (-1.3 për qind); prodhimi i metaleve (-1.0 për qind); dhe energjia elektrike, gazi, avulli dhe furnizimi me ajër të kondicionuar (-0.4 për qind)", ka njoftuar ASK-ja.

Kjo agjenci ka thënë se rënia është neutralizuar me ngritjen e disa çmimeve nga sektori i prodhimitarisë. "Rënia u neutralizua me ngritjen e çmimeve te: nxjerrja e xehes së metalit (7.1 për qind); prodhimi i lëkurës dhe produkteve prej saj (5.9 për qind); prodhimi i produkteve kimike (3.2 për qind); prodhimi i produkteve të fabrikua metalike, përveç makinerisë dhe pajisjeve (2.9 për qind); prodhimi i pajisjeve elektrike (0.6 për qind); xeheroret dhe guroret e tjera (0.4 për qind); dhe përpunimi i produkteve ushqimore (0.4 për




qind). Ndërkaq, krahasuar TM1 2020 me TM1 2019, çmimet e prodhimit u ulën në një mesatare prej (-0.2 për qind)", ka njoftuar ASK-ja.

Më tutje, ASK-ja ka bërë me dije se rënie të mëdha vërehen edhe te disa degë të veprimtarive ekonomike. "Rëniet vërehen te: nxjerrja e xehes së metalit (-5.6 për qind); prodhimi i makinerisë dhe pajisjeve p.k.t. (-4.6 për qind); prodhimi i produkteve minerale jometalike (-2.9 për qind); prodhimi i mobilieve (-2.2 për qind); prodhimi i pijeve (-2.1 për

qind); prodhimi i metaleve (-1.0 për qind); energjia elektrike, gazi, avulli dhe furnizimi me ajër të kondicionuar (-0.9 për qind); prodhimi i drurit dhe i produkteve të tij dhe të tapës, përveç mobilieve: prodhimi i artikujve nga kashta dhe materialeve të gërshetuara-thurëse (-0.8 për qind); prodhimi i letrës dhe i produkteve prej saj (-0.5 për qind); prodhimi i pajisjeve elektrike (-0.5 për qind); grumbullimi, trajtimi dhe furnizimi me ujë (-0.3 për qind); dhe prodhimi i produkteve të

gomës dhe të plastikës (-0.2 për qind). Rënia u neutralizua nga ngritja e çmimeve te: prodhimi i lëkurës dhe produkteve prej saj (7.0 për qind); prodhimi i produkteve të fabrikua metalike, përveç makinerisë dhe pajisjeve (2.6 për qind); prodhimi i mjeteve motorike të (transportit), rimorkiove dhe gjysmë rimorkiove (1.4 për qind); përpunimi i produkteve ushqimore (0.7 për qind); xeheroret dhe guroret e tjera (0.4 për qind); dhe prodhimi i produkteve kimike (0.4 për qind)", ka njoftuar ASK-ja.



## Rukiqi nis vizitat te bizneset anëtare të OEK-ut

PRISHTINË, 5 QERSHOR (ER) - Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës (OEK), Berat Rukiqi, ka filluar vizitat te bizneset anëtare të kësaj ode për ta kuptuar për së afërmi gjendjen dhe kërkesat e tyre pas lehtësimit të masave kundër Covid-19. Rukiqi të premtën ka vizituar

fabrikën "M-technologie", e cila ka të punësuar mbi 200 punëtorë dhe mbulon mbi 80 për qind të kërkesave të përpunimit të xhamit në Kosovë. "M-technologie" është prodhues i dritareve dhe produkteve të tjera nga alumini dhe PVC-ja, ku pjesa më e madhe e prodhimit është e

orientuar në eksport. Gjatë kësaj vizite është diskutuar për rëndësinë e përkrahjes së bizneseve në rimëkëmbjen ekonomike. "Sektori i prodhimit në veçanti dhe mbështetja e eksportit janë pika të rëndësishme që duhet të përkrahen në këtë periudhë", ka njoftuar OEK-u.

## Reçica fillon punën në krye të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale

PRISHTINË, 5 QERSHOR (ER) - Pas marrjes së mandatit nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, të premtën Skënder Reçica nga radhët e Nismës Socialdemokrate ka filluar punën në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS). Ai në llogarinë e vet në "Facebook" ka treguar se çfarë ka biseduar me

administratën e MPMS-së. "Mbajtja një takim njoftues me administratën e MPMS, për t'i identifikuar sfidat që na presin dhe për të rikthyer MPMS-në në mandatin e saj. Falënderova stafin për punën e bërë gjatë pandemisë COVID-19, për angazhimin e tyre në implementimin e masave financiare. Theksova

se duhet vazhduar projektet e filluara në të mirë të qytetarëve për tejkalimin e situatës si dhe për avancimin e projekteve të filluara në mandatin e kaluar për ngritjen e mirëqenies sociale në përgjithësi", ka shkruar Reçica. Ky është mandati i dytë i Reçicës në krye të MPMS-së.



## PDK-ja: LV-ja në Prizren gjatë kohës së pandemisë ka bërë shumë gabime

**PRIZREN, 5 QERSHOR (ER)** - Dega e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) në Prizren ka thënë se qeverisja lokale në këtë komunë, e cila udhëhiqet nga Lëvizja Vetëvendosje, edhe gjatë kohës së pandemisë Covid-19 ka bërë shumë gabime.

Kryetari i kësaj dege, Shaqir Totaj, ka thënë se kanë qenë më të rezervuar në të bërit opozitë, por me qëllim të mbrojtjes së interesit publik do ta vazhdojnë denoncimin e dukurive negative. “Kësaj radhe do të merremi me degradimin urban dhe të ambientit, ku si dukuritë negative në qytetin e Prizrenit, i udhëhequr nga LV-ja dhe kryetari Haskuka, nuk kanë të

ndalur. Një nga dukuritë negative që është në rritje e sipër, është edhe ndërtimi i të ashtuquajturave villa, të cilat tashmë janë ndërtuar në shumë lokacione në territorin e Komunës së Prizrenit. Ky fenomen i degradimit urban ka vazhduar edhe gjatë kohës së pandemisë, që është paradoks i llojit të veçantë dhe në vijim do ta paraqesim rastin më të ri që po ndodh këto ditë. Në lokacionin tek udhëkryqi i vogël afër autostradës, ku gjendet pompa e derivative ‘Arbëria’ dhe pas servisit ‘Mercedes’ dhe sallonit të dasmave ‘Nafon’, tashmë është ndërtuar një kompleks i tillë dhe një tjetër ka

filluar të ndërtohet pikërisht gjatë kohës së pandemisë”, ka thënë Totaj.

Më tutje, ai ka thënë se banorët e shqetësuar në këtë pjesë banimi e kanë ngritur këtë çështje dhe, sipas tij, ata kanë thënë se nga Drejtoria e Urbanizmit janë siguruar se ai projekt në ndërtim e sipër nuk ka leje nga drejtoria në fjalë, por se leja është dhënë nga Ministria e Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor. “Banorët e lagjes kanë kontaktuar edhe me zëvendësministrin e Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor dhe nga ai është konfirmuar se ministria nuk jep leje për



ndërtim në asnjë rast, por raste të veçanta”, është shprehur merret vetëm me ankesa në Haskuka.



## Largohet deponia inerte në fshatin Llapushnik

**DRENAS, 5 QERSHOR (ER)** - Është bërë largimi i mbeturinave në pjesën hyrëse dhe jashtë rrethojës së deponisë inerte në fshatin Llapushnik, e cila ka qenë e bllokuar në hyrjen kryesore duke e bërë deponinë jofunksionale. Komuna e Drenasit u ka bërë thirrje qytetarëve që mbeturinat inerte në deponinë e destinuar t’i hedhin në pjesën e brendshme (pasi ekziston hapësirë e mjaftueshme) e jo në hyrje të saj. “Hedhja e mbeturinave në pjesën hyrëse paraqet problematikë duke bllokuar pjesën e brendshme të saj

dhe duke e bërë jofunksionale deponinë. Me qëllim të parandalimit të hedhjes së mbeturinave jashtë rrethojës, deponia do të jetë në mbikëqyrje të vazhdueshme nga inspektorati në bashkëpunim me zyrtarët e DSHPE/së, në mënyrë që të parandalohet hedhja e mbeturinave në hyrje dhe jashtë saj, ku për të gjithë ata të cilët praktikojnë një gjë të tillë do të merren masa sipas ligjeve në fuqi”, ka njoftuar komuna e Drenasit.

Kjo deponi është caktuar nga Komuna e Drenasit për hedhjen e mbeturinave inerte


nga qytetarët në mënyrë që të parandalohet krijimi i deponive ilegale me përmbytje të mbeturinave inerte. “Inkurajojmë të gjithë qytetarët që mbeturinat inerte t’i hedhin në pjesën e brendshme të deponisë. Në kuadër të aktiviteteve të Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Emergjencë janë larguar deponitë ilegale edhe në fshatin Gllobar, Baicë e Polluzhë dhe ditëve në vazhdim do të largohen deponitë ilegale edhe në vendbanime të tjera”, është theksuar në njoftimin e Komunës së Drenasit.

## Begaj dhe zyrtarë të MIT-së biseduan për fazat e realizimit të projektit të Inkubatorit të Biznesit

**Malishevë, 5 qershor (ER)** - Kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, ka pritur në takim zyrtarin e Ministrisë së Industrisë dhe Tregtisë, Avdi Krasniqin, udhëheqës i zonave ekonomike me bashkëpunëtorë dhe kanë biseduar për fazat e realizimit të projektit të inkubatorit të biznesit në Komunën e Malishevës. Në takim ishte kompania punëkryerëse si dhe punës të Drejtorisë së Urbanizmit, ku të gjitha palët njoftuan se deri ku ka arritur realizimi i projektit të

inkubatorit të biznesit dhe cilat punë të këtij projekti ekonomik duhen përfunduar, që do të ndikojë në zhvillimin ekonomik dhe përmirësim e kushteve të afaristëve dhe të bizneseve në Komunën e Malishevës.

Është bërë me dije se me këtë projekt dhe projekte të reja në të ardhmen që do t’i realizojë Komuna e Malishevës, qytetarëve të saj dhe bizneseve do t’u krijohen mundësi lehtësuese, ku do të përfitojnë në zhvillimin ekonomik dhe mirëqenien e tyre.



## Ahmeti thotë se janë përkujdesur që hapësirat e gjelbra të rriten në Prishtinë

**PRISHTINË, 5 QERSHOR (ER)** - Me rastin e Ditës Botërore të Mjedisit, kryetari i Komunës së Prishtinës, Shpend Ahmeti, në një postim në llogarinë e vet në “Facebook” ka thënë se kjo ditë na kujton rëndësinë e mbrojtjes së mjedisit

ku jetojmë. “Ndër vite jemi përkujdesur që hapësirat e gjelbra të rriten në Prishtinë. E pikërisht tani, o shënohet edhe ‘Prishtina Green Week’. Po mbjellim shumë drunjtë dhe po vendosim plot vazo gjelbëruese anekënd qytetit. Po

punojmë që Prishtinës t’ia kthejmë ngjyrat me pamjen e drunjve e të bimëve. Mjediisi është i pazëvendësueshëm, prandaj ta ruajmë së bashku. Është përgjegjësi e secilit prej nesh!”, ka thënë kryetari Ahmeti.

Me rastin e shënimit të 5 Qershorit - Ditës Botërore të Mjedisit

## Ditë të vështira për mbrojtjen e mjedisit



Shkruan: Dr. sc.  
Ferat SHALA

Sikurse qeveria e sapozgjedhur Hoti, edhe ajo e kaluara, Kurti, çështjen e mbrojtjes së mjedisit e trajtuan fare të parëndësishme në kuadër të përbërjes së dhe strukturës së qeverisë.

Prioritetit i trajtimit të çështjes së mbrojtjes së mjedisit i kësaj qeverie, ashtu sikurse edhe ai i asaj paraprake, u vërejt qysh në fillim të formimit të qeverisë me rastin e bashkimit të ish-Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor me Ministrin e Ekonomisë në qeverinë Hoti dhe me

Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës në qeverinë Kurti.

Bashkime të tilla, lëre më që nuk janë natyrale dhe nuk janë praktika që hasen në ndonjë vend të botës, por janë në kundërshtim të plotë me misionin që ka mbrojtja e mjedisit.

Dihet mirëfilli që në parim misioni i mbrojtjes së mjedisit është zbatimi i mekanizmave dhe instrumenteve që kanë për qëllim të zvogëlojnë dhe parandalojnë ndikimet negative në mjedis nga projektet zhvillimore ekonomike dhe infrastrukturore dhe nga sektorët tjerë e ku ekonomia dhe infrastruktura janë ndër sektorët që kanë ndikimin më të madh.

Duke qenë në të njëjtën ombrellë mjedisi dhe zhvillimi ekonomik ku përfshihet energjia dhe industria apo edhe

infrastruktura dhe transporti është e vështirë të realizohet misioni i mbrojtjes së mjedisit. Është shumë e vështirë të bëhet parandalimi i ndikimeve mjedisore dhe mbi të gjitha është konflikt i drejtpërdrejtë i dy koncepteve që për të funksionuar mirëfilli duhet të jenë të ndara dhe në shërbim të njëra tjetrës e assesi të bashkuara në një tërësi të vetme.

Andaj lirisht mund të thuhet se trajtimi në këtë formë i dikasterit të mbrojtjes së mjedisit në kuadër të këtyre dy qeverive është lënë tërësisht nën hijen e sektorëve tjerë dhe se trajtimi i çështjeve mjedisore nuk është në nivelin që kërkohet për të ofruar një mbrojtje dhe menaxhim të qëndrueshëm të resurseve natyrore dhe përmirësimin e cilësisë së ajrit, ujit dhe tokës apo edhe për zbutjen e ndryshimeve klimatike.

Konceptet moderne të menaxhimit të mjedisit promovojnë zhvillimin e qëndrueshëm dhe shfrytëzimin e qëndrueshëm të resurseve natyrore ku sektorët zhvillimorë sikurse janë ekonomia, industria, energjetika, transporti dhe infrastruktura duhet të zbatojnë parimet e zhvillimit të qëndrueshëm dhe të përmbushin standarde mjedisore duke iu nënshtruar instrumenteve dhe mekanizmave që rekomandohen nga dikasteret e mbrojtjes së mjedisit, e assesi që mjedisi të jetë pjesë e dikasterëve përkatëse zhvillimore vetëm si një dekor apo formalitet i parëndësishëm. Një çështje tjetër, po ashtu, e rëndësishme që është neglizhuar skajshëm dhe në mënyrë aspak profesionale nga të dy qeveritë në fjalë është edhe çështja e ndërrimit të emërimit nga “mjedis” në “ambient”. Ky

ndryshim i emërimit, përveç që zëvendëson një fjalë shqipe me një fjalë të huaj, na kthen 20 vjet prapa. Qysh nga koha e formimit të institucioneve të para qeverisëse të Kosovës janë hartuar ligje, udhëzime, rregullore, plane, programe e strategji ku gjithmonë është përdorur fjala “mjedis”. Tani me emërtimin e ri “ambient”, krijohen jo vetëm telashe ligjore, administrative dhe konceptuale por edhe organizative dhe strukturore meqenëse të gjitha emërtimet e strukturave të tjera administrative të nivelit qendror dhe lokal përfshirë agjenci, departamente, drejtori e sektorë përdoret fjala “mjedis” dhe jo “ambient”.

Bazuar në këtë qasje, lirisht mund të thuhet se sektorin e mbrojtjes së mjedisit e presin ditë të vështira dhe se degradimi mjedisor pritet të përshkallëzohet edhe më tutje!

## Kush u zotua për dhe po punon kundër “Alternativës shqiptare demokratike - Lugina e bashkuar”



Dr. scc. Baki REXHEPI

Për herë të parë pas përfundimit të luftës në Luginë të Preshevës partitë shqiptare dalin më të “bashkuara” se kurrë në zgjedhjet parlamentare në Serbi që do të mbahen më 21 qershor. Gjithçka ishte nisur me një interesim të shtuar të Tiranës zyrtare për të rritur një Bashkim të spektrit politik për pjesëmarrje në zgjedhjet parlamentare. Kurorëzimi i angazhimeve të ministrit të Jashtëm shqiptar Gent Cakaj ishte arritur me nënshkrimin e marrëveshjes për koalicionin parlamentar nga pesë subjekte, PVD, APN, PD, LPD dhe LRPDSH. Marrëveshja kishte definuar Partinë për Veprim Demokratik si subjekti i cili do t'i prijë kësaj liste, duke respektuar me gjasë

përvojën e gjatë të parlamentarizmit të këtij subjekti, por, edhe fuqinë politike rajonale që PVD e ka. Gjendja e jashtëzakonshme dhe lufta kundër Covid-19, e cila kishte prolonguar mbajtjen e zgjedhjeve, fillimisht të përcaktuara për 24 prill, ndërpreu edhe aktivitetet e partive nënshkruese procedurën për zgjedhjet parlamentare. Tash, kur sërish ka rifilluar procesi zgjedhor në Serbi, edhe këto pesë parti arritën mes veti të dakordojnë edhe pjesët teknike të marrëveshjes së koalicionit për pjesëmarrje në zgjedhjet parlamentare nën Moton Lugina e Bashkuar.

Secila parti ka përcaktuar kandidatët e vet dhe lista e përbashkët pritet t'i ketë 12 kandidatë.

Tashmë është e qartë se numri një në listë, i cili i takon PVD-së, do të përfaqësohet nga Shaip Kamberi, kryetar i PVD dhe kryetari aktual i Bujanocit. Secila parti e ka pas të qartë këtë fakt që në momentin e nënshkrimit të Marrëveshjes, së paku asaj

teknike.

Tanimë, kur procesi zgjedhor gjendet në fazën e grumbullimit të 10 mijë nënshkrimeve të nevojshme, në parim, gjithçka duhet të jetë normale. Megjithatë, siç thotë një fjalë e urtë “drejt flenë në detaje” edhe kësaj radhe duket se “drejt po bën punën e vet” duke mos lënë rehat idenë e listës së përbashkët.

Dy nga pesë partitë, kanë nisur një fushatë të nivelit të ulët politik e moral kundër kandidatit numër një në listë Shaip Kamberi.

Me lajme të rrejshme, keqpërdorime të gjysmë informacioneve apo fabrikim të informacioneve, ato po tentojnë ta njollosin bartësin e projektit të Tiranës.

Pse ndodh kjo, është për të u habitur. Është kjo për shkak të interesave lokale që këto subjekte e kanë në zgjedhjet lokale të cilat në Bujanoc do të mbahen të njëjtën ditë, apo në prapaskenë ka edhe plane tjera të cilat po tentojnë ta prishin projektin e Tiranës?

I pari i listës parlamentare,

Shaip Kamberi, nuk është kandidat për kryetar komune për Bujanoc, që do të thotë nuk është rival i drejtpërdrejtë i asnjërës parti politike në Bujanoc.

Interesi i përbashkët i pesë partive nënshkruese të marrëveshjes së Tiranës është që të mblidhen sa më shumë vota për nivel parlamentarë me qëllim që numri i deputetëve shqiptarë i dalë nga këto zgjedhje të jetë së paku dy e me dëshirë edhe tre deputetë.

Por, fushata shpifëse që po e ndjekin këto dy subjekte, po e dëmton rëndë interesin e listës së përbashkët. Më këtë fushatë këto subjekte po i dërgojnë mesazhe elektoratit të vet që nuk duhet të votohet lista parlamentare, pra ato me këtë rrezikojnë edhe arritjen e votave të mjaftueshme për një deputet.

Kjo jo që dëmton rëndë Marrëveshjen e arritur në Tiranë, por, tregon për dyfytërsinë e këtyre subjekteve ndaj elektoratit të vet.

Së pari, nëse këto subjekte kanë vërtetë fakte kundër

Shaip Kamberit, do të ishte morale e burrërore, me veprim të përgjegjshëm politik, të tërhiqen nga lista e përbashkët.

Përndryshe, duke vazhduar të qëndrojnë në listën e përbashkët, e në anën tjetër të bëjnë fushatë të njolloshjes së kandidatit të parë të kësaj liste, ato po e nënçmojnë së pari elektoratin e vet. Nuk janë të sinqertë, në radhë të parë ndaj votuesve të tyre. Kjo mungesë e përgjegjësisë politike të këtyre subjekteve, nuk mund të korrigjohet ndryshe veç me ndërhyrje të drejtpërdrejtë të Tiranës zyrtare. Ajo që ishte kumbarë e këtij koalicioni duhet të marrë përgjegjësinë edhe për mbarëvajtjen e tij. Fundja, ajo ka mekanizmat e domosdoshëm edhe për të disiplinuar ata që për interesa të kushedi kujt cenojnë një projekt të përbashkët shqiptar, që po ndodhë për herë të parë. Të shpresojmë edhe në seriozitetin e Tiranës zyrtare sa nuk është bërë vonë!

(Analiza përmban mendimin personal të autorit)

## Mbi 40 mijë persona të vdekur nga koronavirusi në Britani të Madhe

LONDËR, 5 QERSHOR - Numri i personave të vdekur si pasojë e koronavirusit në Britaninë e Madhe ka tejkaluar shifrën 40 mijë. Ky lajm vjen pas raportimit të 357 viktimave të reja me këtë virus nëpër spitalet britanike, shtëpitë e kujdesit dhe pjesën tjetër të komunitetit ka njoftuar Departamenti për Shëndetësi.

Aktualisht numri i të vdekurve në Britani nga Covid-19 është rritur në 40 261. Britania e Madhe është vendi i dytë në botë me numrin më të madh të të vdekurve si pasojë e sëmundjes Covid-19 që shkakton koronavirusi. Në muajin mars këshilltari qeveritar, Patrick Vallance, pati thënë se mbajtja e numrit të

vdekjeve nën 20 000 do të përbënte "rezultat të mirë". Përndryshe, Shtetet e Bashkuara janë prekur më së keqi në botë nga koronavirusi i ri. Sipas të dhënave të Universitetit "Johns Hopkins", 1.8 milion persona janë infektuar me këtë virus në territorin amerikan. Prej tyre, mbi 100 000 kanë vdekur.



## ShBA-ja akuzon 'aktorë të huaj' për nxitje tensionesh në internet

WASHINGTON, 5 QERSHOR - Kundërshtarët e ShBA-së kanë filluar t'i përdorin si armë protestat që kanë rrokur disa pjesë të vendit me qëllimin për "të mbjellë përçarje e mosmarrëveshje", kanë thënë zyrtarë të lartë të zbatimit të ligjit të cilët nuk kanë pranuar të japin detaje shtesë. Protestat për vrasjen e George Floyd, një afrikano-amerikan, i cili vdiq ndërsa ishte ndaluar nga policia, kanë tërhequr vëmendjen e mbarë botës, duke marrë një mbulim të konsiderueshëm mediatik në Rusi, Kinë dhe Iran. Departamenti Amerikan i Drejtësisë dhe FBI kanë thënë se disa vende, por pa përmendur emra, po shkojnë një hap më tej, duke manipuluar në mënyrë aktive informacionin për ta përkeqësuar situatën në Shtetet e Bashkuara. "Besoj se kemi prova se disa prej hakerave dhe grupeve të huaja që janë të lidhura me qeveri të huaja po përqendrohen te kjo situatë e veçantë në të cilën ndodhet vendi ynë, duke u përpjekur ta përkeqësojmë atë në çdo mënyrë që mundet", ka thënë prokurori i përgjithshëm William Barr të enjten në një konferencë për shtyp në lidhje me protestat. Më tutje, Barri ka akuzuar aktorët e huaj se "po vënë në lojë të gjitha palët për ta përkeqësuar dhunën". Drejtori i FBI-së nuk ka pranuar të japë informacione shtesë, por ka paralajmëruar se kushdo që zhvillon fushata dezinformimi ose ushtron ndikim për ta dëmtuar ShBA-në nuk do të shpëtojë i padëmtuar. "Ata aktorë të huaj duhet ta dinë që ne po e shohim këtë situatë nga afër dhe jemi të përgatitur të veprojmë nëse do të jetë e



nevojshme", ka thënë ai.

Por analistë të pavarur dhe ekspertë të kontaktuar nga "Zëri i Amerikës" kanë vënë në dyshim pretendimet e qeverisë, duke thënë se ndërsa nuk ishte e pamundur që disa grupe të lidhura me qeveri të tjera t'i kenë rafinuar taktikat e tyre duke kryer operacione të sofistikuara ndikimi, në internet kishte pak gjurmë ose fare mbi këtë çështje. "Ne nuk kemi parë ndonjë provë të hapur për operacione të qëndrueshme, të fshehta në internet që synojnë aktivistët dhe protestat në Shtetet e Bashkuara" ka thënë Graham Brookie, drejtori i Laboratorit Kërkimor Mjeko-Ligjor në Këshillin e Atlantikut me qendër në Uashington, duke shtuar se shumica e mesazheve vijnë në vendet kundërshtarë të ShBA-së. "Shumica e mesazheve që ne po shohim nga Rusia, Kina, Irani, Venezuela e të tjera vende në lidhje me protestat aktuale në Shtetet e Bashkuara i drejtohet audiencës së atyre vendeve", ka thënë Brookie.

Megjithatë, ai ka paralajmëruar se në këtë pikë mungesa e provave mbi operacione me

qëllim ndikimi nuk ishte diçka tejet befasuese. "Në krahasim me redaksitë e lajmeve, zakonisht kërkim më shumë kohë për agentët e huaj që kryejnë operacione ndikimi, që të përshtaten me ngjarje në zhvillim", ka thënë ai.

Departamenti i Drejtësisë nuk iu përgjigj kërkesës së "Zërit të Amerikës" për informacione shtesë dhe FBI-ja nuk ka pranuar të japë komente. Studiues si ata të Laboratorit Kërkimor Mjeko-Ligjor, kanë thënë se duket se kundërshtarët e ShBA-së janë të kënaqur, për momentin, për t'i përqendruar përpjekjet e tyre në sigurimin që vdekja e Floydit dhe protestat të jenë në faqet e mediave që mbështeten nga shteti dhe në mediat sociale, përjashtuar rastin e shfaqjes së prova të reja që dëshmojnë të kundërtën. Sipas një analize të "Aleancës për Garantimin e Demokracisë", një organizatë në Uashington që përpiket t'i dokumentojë dhe ekspozojë "përpjekjet e vazhdueshme për ta shkatërruar demokracinë", hashtagu me emrin e George Floyd (#GeorgeFloyd) ishte lajmi kryesor në mesin e të gjitha

### Dempsey: Kërcënimi i Trumpit me ushtri, "i rrezikshëm"

WASHINGTON, 5 QERSHOR - Një tjetër ish-oficer i lartë i ushtrisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA) ka dënuar kërcënimet e presidentit Donald Trump për t'i përdorur trupat ushtarake kundër protestuesve në ShBA.

Ish-shëfi i shtabit të përgjithshëm, gjenerali Martin Dempsey, ka thënë se deklaratat e Trumpit janë "shumë shqetësuese" dhe "të rrezikshme". "Ideja që presidenti ta marrë përsipër situatën duke përdorur ushtrinë ishte shqetësuese për mua", ka thënë Dempsey për Radion Kombëtare Publike. Ai ka shërbyer si oficeri më i lartë ushtarak i Amerikës nën ish-presidentin Barack Obama.

Në ShBA, qysh në fund të majit po protestohet për vdekjen e afrikano-amerikanit George Floyd, gjatë arrestimit nga policia. Disa protesta kanë rezultuar edhe me zjarrvënien dhe plaçkitje. Trumpi ka kërcënuar të hënën se do ta pozicionojë

ushtrinë "për ta zgjidhur shpejt" situatën nëse shtetet nuk arrijnë. Kritik e Dempseyt vijnë një ditë pasi ish-sekretari i mbrojtjes i Trumpit, James Mattis, njëherësh ish-gjeneral i marinës, ka kritikuar presidentin duke thënë se ai qëllimisht shkakton ndarje. "Donald Trump është presidenti i parë në jetën time, i cili nuk përpiqet ta bashkojë popullin amerikan, as nuk pretendon të provojë", ka shkruar Mattisi në revistën "Atlantic".



llogarive në mediat sociale të diplomacisë ruse dhe mediat e mbështetura nga shteti, prej së premtes deri të dielën në mbrëmje.

Hashtagu George Floyd (#GeorgeFloyd) ishte gjithashtu hashtagu i tretë më popullor në mesin e llogarive diplomatike kineze dhe medias shtetërore. Disa analistë kanë paralajmëruar se jo e gjithë kjo ka si synim domosdoshmërisht mbjelljen e përçarjeve brenda ShBA-së. Një pjesë e mbulimit mediatik dhe propagandës në

lidhje me protestat, kanë thënë ata, ka më shumë lidhje me politikën globale. "Ajo ka krijuar mundësi që kundërshtarët e Shteteve të Bashkuara në të gjithë botën, Kina, Rusia, Koreja e Veriut, Irani, të peshojnë një qasje ideologjike që u mundëson atyre të flasin mbi dobësitë e sistemit amerikan, rendit liberal demokratik", i ka thënë shërbimit korean të VOA-s, Ken Gause, drejtor i Analitikës Kundërshtarë në CNA, një qendër mendimi në Uashington.

## Erdogani zbrapset nga vendimi për rikthim të masave të izolimit

ANKARA, 5 QERSHOR - Presidenti turk Rexhep Taip Erdogan ka anuluar planet për t'i rikthyer masat e izolimit në disa qytete, duke thënë se duhet të mënjanohen "pasojat shoqërore dhe ato ekonomike". Ministria e Brendshme ka bërë me dije planet për kufizim të lëvizjes natën gjatë fundjavës, në 15 qytete, përfshirë Stambollin dhe Ankarën. Megjithatë, Erdogani

më vonë ka thënë se ka vendosur të anulohet këto plane, pas kundërshtimeve që kanë shprehur qytetarët. Turqia ka rihapur restorantet, kafiteritë dhe plazhet më herët gjatë kësaj jave, si dhe ka mundësuar udhëtimin e brendshëm. Erdogani pati thënë më herët se është e nevojshme një valë e dytë e izolimit, pasi numri i rasteve ditore me koronavirus kishte arritur në gati 1 000

ditën e enjte. "Si rezultat i këtij zhvillimi negativ ne kemi besuar se duhet rikthyer në agjendën tonë urdhrin për qëndrim në shtëpi. Megjithatë, reagimet që kemi pranuar nga njerëzit na kanë shtyrë që ta rishqyrtojmë vendimin", është shprehur Erdogan. Në gjithë Turqinë, me koronavirus janë infektuar më shumë se 165 000 persona, ku prej tyre 4 609 kanë vdekur.





# ILIRE VINCA FTOHET TË BËHET PJESË E AKADEMISË EVROPIANE TË FILMIT

Aktorja e njohur kosovare Ilire Vinca është ftuar të bëhet pjesë e Akademisë Evropiane të Filmit. Ilire Vinca ka një karrierë të pasur si aktore e filmit, teatrit dhe si profesore dhe aktrimit në Universitetin e Prishtinës.

Ajo u bë e njohur edhe si aktorja e parë që mori pjesë në Berlinale me filmin 'Falja e Gjakut' në 2011, pastaj edhe me filmin 'Burrneshat' në 2015 poashtu në Berlinale. 'Zana', 'Pranverë e paharruar në fshatin e harruar', 'Gardhi', dhe 'Martesa' janë disa nga filmat e fundit kosovar ku luan Ilirja.

"Përderisa kufinj të na ndajnë, arti na bashkon pa dallim race e gjinie, ashtu siç janë ndjenjat dhe e vërteta. Jam e nderuar të jem anëtare e Akademisë Evropiane të Filmit" u shpreh aktorja kosovare Ilire Vinca.

Akademia Evropiane e Filmit është themeluar në vitin 1989 me drejtorin e parë Ingmar Bergman bashkë me anëtarët tjerë themelues si Pedro Almodovar, Lindsay Anderson, Bernardo Bertolucci, Sir Ben Kingsley, Andrzej Wajda, Wim Wenders etj.

Ilire Vinca është anëtarja e 25-të nga Kosova që bëhet pjesë Akademisë Evropiane të Filmit.



**E rrallë**

## Në Francë krijohen kapelat me përmasa të mëdha që ruajnë distancën fizike

Kapelat mund të jenë edhe një zgjidhje interesante për të siguruar që personat t'i respektojnë distancat mes njëri-tjetrit në kohë të rrezikut pandemik. Këtë mënyrë po përdor një galeri franceze për vizitorët e saj. Një galeri arti në Francë po përdor imagjinatën, por edhe referenca historike për të aplikuar masa të distancimit fizik prej



pandemisë. Artistët e galerisë "59 Rivoli" janë frymëzuar nga dinastitë e lashta kineze për të krijuar kapela me përmasa të mëdha që shmangin kontaktet e afërta mes vizitorëve nga rreziku i koronavirusit.

**FOTO E DITES**




Qytetarët në Spanjë marrin reze dielli duke ruajtur distancën ndaj Covid-19 në plazhin La Concha. /EPA/

**E jashtëzakonshme**

## Nuk kishin para për shtëpi të re, vendosën që anijen e viteve '60 ta shndërrojnë në shtëpi

Një çift që nuk patën para të mjaftueshme për të blerë një shtëpi në Londër kanë arritur që anijen transportuese të ndërtuar në vitet '60 ta shndërrojnë në një shtëpi lundruese me dy kate brenda së cilës nuk mungon pothuajse asgjë. Christina Miles, 33-vjeçare, dhe partneri



i saj Rohan Tully, 36-vjeçar, që janë së bashku për më shumë se 13 vjet dhe kanë një vajzë njëvjeçare Elara, jetojnë në anijen e tyre e cila aktualisht është e ankoruar në afërsi të urës Kew në lumin Thames në jugperëndim të Londrës.

**BARSOLETA E DITËS**



**E pyet nxënësi mësuesen:**  
 - Pse kur martohet nusja vishet me të bardha?  
 - Sepse për të është ditë gëzimi, - iu përgjigj mësuesja.  
 - Tani e kuptova pse dhëndri vishet me të zeza, - tha nxënësi.



**Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC**

**Në ora 18:00 Spies in Disguise 3D**

I Animuar/Aksion/Aventurë; 1 orë 42 min

**Rolet:** Will Smith, Tom Holland, Ben Mendelsohn, Karen Gillan, Rashida Jones, DJ Khaled, Masi Oka

**Regjia:** Troy Quane, Nick Bruno



**Në ora 18:00 Jumanji; The Next Level 3D**

Aksion/Aventurë/Komedi; 2 orë 03 min  
**Rolet:** Dwayne Johnson, Jack Black, Kevin Hart, Karen Gillan, Nick Jonas, Awkwafina, Ser'Darius Blain, Madison Iseman, Morgan Turner, Alex Wolff, Danny Glover, Danny DeVito, etj.  
**Regjia:** Jake Kasdan



**Çdo natë në ora 20:00 STAR WARS; THE RISE OF SKYWALKER 3D**

Aksion/Aventurë/Fantazi; 2 orë 21 min  
**Rolet:** Daisy Ridley, Adam Driver, Mark Hamill, John Boyega, Oscar Isaac, etj  
**Regjia:** J.J. Abrams



**Çdo natë në ora 22:30 THE GRUDGE**

Horror/Mister; 1 orë 34 min

**Rolet:** Sarah Michelle Gellar, Jason Behr, Kadee Strickland, Clea Duvall and Bill Pullman

**Regjia:** Takashi Shimizu



**Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.**

 <p><b>DASHI</b> Ju mund të mendoni se si ta ndryshoni rrugën e zakonshme. Kjo më së shumti iu referohet pushimeve tuaja.</p>	 <p><b>DEMI</b> Nesër do t'ju duhet të bëni disa vendime të rëndësishme. Mund të mendoni për të ecur në një fushë tjetër në jetën tuaj profesionale.</p>	 <p><b>BINJAKËT</b> Të lindurit e kësaj shenje mund ta ndryshojnë kursin e jetës. Kjo mund të varet nga rrethana të veçanta.</p>	 <p><b>GAFORRJA</b> Nuk duhet të ndiheni të kënaqur me role sekondare. Ekziston rreziku të humbisni një shans mjaft të mirë ose në fushën e dashurisë.</p>	 <p><b>LUANI</b> Ata që luftojnë për një karrierë të suksesshme duhet t'i besojnë intuitës. Merrni parasysh këshillat e të tjerëve.</p>	 <p><b>VIRGJËRESHA</b> Mund të pushtoheni nga emocione negative. Kjo mund të vijë për shkak të një incidenti në mëngjes.</p>
 <p><b>PESHORJA</b> Megjithatë, suksesi juaj nuk do të jetë aty ku dëshironi, pasi nuk do ta keni mbështetjen e duhur të njerëzve tuaj më të dashur.</p>	 <p><b>AKREPI</b> Planet që kishit menduar mund të mos realizohen të gjitha. Megjithatë, përpikuni të përshtateni me kursin e jetës.</p>	 <p><b>SHIGJETARI</b> Meditimi apo ushtrimet fizike do të jenë mjaft të nevojshme për ju. Nëse i merrni këto këshilla në konsideratë, gjithçka do të jetë nën kontroll.</p>	 <p><b>BRICJAPI</b> Do të jetë një ditë e zakonshme, pa probleme të mëdha. Nëse dëshironi ta ruani vendin tuaj të punës, mos kundërshtoni vazhdimisht drejtuesin tuaj.</p>	 <p><b>UJORI</b> Mos u bëni nostalgjik, pasi mund të humbisni një shans shumë të rëndësishëm. Duhet të merrni patjetër një këshillë në konsideratë: jetoni të tashmen dhe jo të kaluarën.</p>	 <p><b>PESHQIT</b> Kjo ditë do të kalojë pa shumë pengesa. Planet tuaja do të zbatohen, mbi të gjitha nëse do ta keni mbështetjen e dikujt me rëndësi në jetën tuaj.</p>

## Melania vë sërish në siklet Donald Trumpin, videoja bën xhiron e botës



Nuk janë të rralla rastet kur Melania Trump e ka vendosur në siklet bashkëshortin publikisht. Videot ku ajo nuk pranon t'i japë dorën apo i shmanget puthjes së presidentit Trump janë të shumta. Mirëpo, një tjetër video e sikletshme e çiftit presidencial po bën xhiron e rrjetit. Gjatë një shfaqjeje

publike në Uashington çifti ndaloi për të bërë foto. Ajo që ra në sy ishte fytyra e vrenjtur e Zonjës së Parë. Teksa Trump mudohej të dukej i qeshur, Melania kishte një pamje të akullt në fytyrë. Në një moment ai i kërkoi bashkëshortes të buzëqeshë, ndërsa ajo vendos pak buzën në gaz.



## Loredana, pjesë e klipit të ri të Zunës

Zuna ka lansuar projektin më të ri muzikor për të cilin ka marrë një përkrahje të madhe edhe nga Loredana. Këngën të cilën reperi gjerman e ka titulluar 'Benzema' e shoqëroi edhe me klip, pjesë e së

cilës është edhe reperja me prejardhje shqiptare. Kujtojmë se muajin e kaluar dyshja kishin punuar edhe në një duet, 'Du bist mein', i cili tani ka arritur të marrë miliona klikime në Youtube.

## Familja Mbretërore e Monakos në daljen e parë publike, të gjithë me maska



**E**dhe te princat e Monakos kthehet normaliteti. Familja Mbretërore, pothuajse e gjitha, ka festuar për sheshin e ri të Casino të Monte Carlos. Në daljen e parë të tyre publike pas lockdown ata janë shfaqur me elegancë se asnjëherë, të veshur me ngjyra të hapura dhe të

shkëlqyera si shenjë optimizmi pas shumë ditëve të errëta. Mbi të gjithë, spikat Charlene Wittstock, e veshur me ngjyra të hapura dhe me një model të ri flokësh. Në maskën e princit dhe të princeshës shfaqet mesazhi i shpresës: Të fortë së bashku.

## Izraeli nënshkruan peticion: Ndaloni transmetimin e këngëve të Dua Lipës



**N**jë peticion ka nisur në Izrael, ku po bën thirrje që këngët e Dua Lipës të ndalohen në radio, pasi këngëtarja ndau në llogarinë e saj në

"Instagram" një postim anti-izraelit, ku pretendonte se ushtarët qëllonin fëmijë, mes pretendimeve të tjera. Mbi 3 000 njerëz kanë nënshkruar deri më tani këtë peticion.

# 'Po çmendem përsëri': Rrëfimi tragjik i vetëvrasjes së Virginia Woolf-it

Nga Hannah McKennett

Letra e vetëvrasjes së Virginia Woolf-it dhe vendimi fatal për të hyrë në lumin Ouse me gurë në xhepa, vetëm sa fillojnë të na tregojnë historinë e vdekjes së saj të trishtë. Veprat e shumta të shkrimtares angleze vazhdojnë të ndikojnë në kulturën moderne edhe pas më shumë se një shekulli pasi u shkruan. Ndërsa romanet e vlerësuara, si Zonja Dalloway, dhe esetë e njohura feministe, si Një dhomë më vete, mbeten joshëse edhe sot e kësaj dite, ashtu ndodh edhe historia e vetëvrasjes së saj, kur një ditë në fillim të pranverës së vitit 1941 ajo mbushi xhepat me gurë dhe u zhyt në një lumë pranë shtëpisë ku banonte. Por pas rrëfijës për vdekjen është historia e paharrueshme e një gruaje e cila luftoi me tragjedinë dhe sëmundjen mendore gjatë pjesës më të madhe të jetës, me së fundi duke iu nënshtruar mendimeve të saj pikëlluese.

## Gruaja pas tragjedisë

Lindur më 25 janar 1882, Virginia Woolf-i (me emrin Adeline Virginia Stephen) ishte me status të veçantë. Prindërit, sër Leslie Stephen dhe Julia



Stephen, ishin personalitete të shquara në komunitetin e tyre në Londër. Të dy ishin shkrimtarë, Leslie punonte si redaktor i Fjalorit të Biografisë Kombëtare dhe Julia kishte shkruar një libër për profesionin e saj, infermierinë. Woolf-i dhe e motra, Vanesa, u shkolluan në fillim në shtëpi në bibliotekën e madhe të babait. Shumë shpejt, të dyja studiuuan në King's College London, në departamentin për zonjat me titullin "Ledi".

Pas diplomimit, Woolf-i u përhum sakaq në botën e letërsisë, duke iu bashkuar një rethi artistësh dhe



intelektualësh të njohur si Grupi Bloomsbury. Këtu takoi bashkëshortin e ardhshëm, eseistin Leonard Woolf. Menjëherë pas martesës në vitin 1912, çifti bleu një shtypshkronjë, Hogarth Press, dhe botuan veprat e shkrimtarëve, si Sigmund Freud dhe T. S. Eliot.

Woolf filloi të botojë edhe shkrimet e veta, duke filluar me romanin Udhëtim për matanë, në vitin 1915. Megjithatë, vërtet e famshme u bë me romanin e katërt, Zonja Dalloway. I botuar në vitin 1925, ky roman trajtoi tema moderniste, si feminizmi, sëmundja mendore dhe homoseksualiteti.

Woolf-i më pas botoi romane të tjera të rëndësishme dhe të njohura, si Udha për te fari dhe Orlando, si dhe esetë feministe, Një dhomë më vete dhe Tri monedha ari. Të gjitha këto vepra i sollën suksesin dhe vlerësimin nga kritika si shkrimtare e shquar e ndryshimeve rrënjësore letrare. Por, pas disa përpjekjesh të dështuara për vetëvrasje, ishte më se e qartë se gjendja shëndetësore e Woolf-it nuk ishte e mirë.

## Çfarë e shkaktoi vetëvrasjen e Virginia Woolf-it?

Virginia Woolf-i ka thënë: "Të rritesh, do të thotë të humbësh disa iluzione, në mënyrë që të krijosh iluzione të tjera." Ajo humbi shumë nga iluzionet e saj kur ishte fëmijë për shkak të disa traumave. E para nga këto ndodhi kur vëllezërit nga nëna, me martesën e parë, George dhe Gerald Duckworth, filluan të abuzojnë seksualisht me të. Në

esetë personale Woolf-i zbuloi se abuzimi filloi që kur ishte gjashtë vjeçe deri në moshën 23-vjeçare, kur u largua nga ajo shtëpi për të mos jetuar më me familjen. Ndërsa ky abuzim seksual ka të ngjarë të ketë shkakuar shumë nga problemet me sëmundjen mendore, vdekja e nënës në vitin 1895 u duk se i forcoi ato. Menjëherë pas kësaj, në moshën 13-vjeçare, Woolf-i pati çrregullimet e para mendore.

Gjatë viteve pas vdekjes së nënës ajo pësoi disa trauma me radhë. Motra nga nëna, Stela, ndërroi jetë dy vjet më vonë dhe në vitin 1904 babai i vdiq nga kanceri në stomak. Shumë shpejt pas këtyre humbjeve Woolf-i nisi të kurohej, megjithëse për një kohë të shkurtër.

Edhe pas suksesit në letërsi dhe martesës së lumtur me Leonardin, Woolf-i vazhdoi të përballej me depresionin dhe sëmundjen mendore. Bëri disa përpjekje për vetëvrasje dhe vuajti nga halucinacionet, si dhe nga periudha manie. Provoi trajtime të ndryshme psikiatrike, por për shkak se humbimti i shëndetit mendor ishte në hapat e parë në atë kohë, ato patën vetëm rezultate negative. Një nga këto trajtime përfshinte edhe heqjen e disa dhëmbëve, një teori e zakonshme mjekësore në vitet 1920 që e shoqëronte sëmundjen mendore me infeksionet dentare.

## Letra e vetëvrasjes dhe çastet e fundit

Në mëngjesin e 28 marsit 1941 Leonard Woolf-i e dinte se diçka nuk ishte në rregull me bashkëshortin e tij prej 29

vjetësh. Pasi foli me të në studion jashtë shtëpisë në Sussex, e këshilloi të hynte brenda dhe të pushonte. Kjo ishte hera e fundit që Leonard i pa gruan të gjallë.

Pasi Leonard shkoi në zyrë, Woolf-i veshi pallton dhe çizmet me qafë, doli nga porta e përparme dhe u nis drejt lumit Ouse pranë shtëpisë së tyre. Kur Leonard u ngjit lart për të kontrolluar disa orë më vonë, gjeti dy letra para vetëvrasjes të lëna nga bashkëshortja. Njëra i drejtohej atij dhe tjetra motrës, Vanesa-s.

Në shënimin e lënë për të shoqin shkruhej: "I shtrenjtë im, jam e sigurt se po çmendem përsëri. Ndiej se s'mund ta përballojmë edhe një periudhë tjetër me këtë përvojë të tmerrshme. Kësaj here s'do ta marr dot veten. Filloj të dëgjoj zëra dhe s'mund të përqendrohem. Kështu po bëj atë që duket gjëja më e mirë për të bërë."

Më tej në letrën e vetëvrasjes lexojmë: "Ajo që dua të them, është se gjithë lumturinë e jetës sime e kam pasur falë teje. Ke qenë përherë i durueshëm me mua dhe jashtëzakonisht i mirë. Po e them që ta dinë të gjithë. Po të kishte njeri që do të mund të më kishte shpëtuar, do të ishe ti. Gjithçka është zhdukur brenda meje, por jo siguria e mirësisë sate. S'mendoj se dy njerëz mund ishin më të lumtur sesa ishim ne."

I tronditur pasi lexoi letrën e vetëvrasjes, Leonard kontrolloi rreth e rrotull. Shumë shpejt gjeti gjurmët e saj dhe bastunin në bregun e lumit, por uji tashmë ia kishte zhdukur trupin. Do të gjendej tri javë më vonë, pasi ujërat ta nxirrnin në breg të Southease-it, Angli. Kur u njoftua

vdekja e Virginia Woolf-it, T. S. Elioti shkroi se ky ishte "fundit i një bote".

## Trashëgimia e përhershme e vdekjes së Virginia Woolf-it

Pas vdekjes, trupi iu dogj dhe hiri u shpërnda nën dy vidha, me emrat "Virginia" dhe "Leonard", në oborrin e shtëpisë së çiftit. Leonard kishte vënë aty një gur ku ishin gdhendur rreshtat e fundit nga romani i saj Dallgët: "Vërvitem drejt teje, e pamposhtur, e paepur, O Vdekje! Dallgët u përplasën në breg." La një roman dhe autobiografinë e papërfunduar. Letra e vetëvrasjes do të ishte ajo çfarë shkroi për herë të fundit.

Megjithatë, emri dhe kujtimi i Woolf-it vijojnë të jetojnë. Romanet i janë kthyer në romane të dashura klasike, ndërsa esetë në ikonë moderne feministe. Ajo, madje, u bë e pavdekshme në romanin fitues të çmimit "Pulitzer", Orët e Michael Cunningham-it, me Nicole Kidman si aktore në filmin që mbështetet te ky libër.

Përpos kësaj, vdekja e Virginia Woolf-it frymëzoi një ekip studiuesish për të krijuar një aplikacion i cili parashikon prirjet për vetëvrasje të një



personi mbështetur në atë që shkruan. Duke studiuar ditarin e Woolf-it, të mbajtur gjatë gjithë jetës, si dhe letrat personale, ekipi shpreson të krijojë një softuer që mund të analizojë tekste, postën elektronike dhe postimet në mediat sociale të pacientëve në rrezik. Kur aplikacioni identifikon një ndryshim negativ në shkrimet e pacientit, menjëherë paralajmëron një kujdestar për të ndërhyrë në kohë.

Në këtë mënyrë, Virginia Woolf-i la pas një trashëgimi që është shumë më e madhe se jeta apo vdekja e saj. Diku ka shkruar: "Kur mendon për gjëra si yjet, vogëlimat tona s'duket të kenë edhe aq rëndësi apo jo?" / Exlibris



# Henrik Ibsen përballë Maksim Gorkit

Si u bë poezia Zgalemi prozë poetike – Kënga e Zgalemit apo Lajmëtari i furtunës

1

Në përgjithësi, të gjitha gjërat thelbësore të kësaj bote janë thënë qyshkur; dokumentimi është i fiksuar nëpër libra, përveçse në memorien e njerëzve. Njerëzve të brezave me radhë u pati mbetur t'i përsëritnin në forma, mënyra, trajta e gjendje të ndryshme ato që, në thelb, janë të njëjta prej mijëra vjetësh, duke shpaluar detajet vetjakësore që janë të pafundme. "Ne jemi në një epokë ku të gjitha fjalët tanimë janë thënë". (S. Averincjev, kulturolog rus) Ne përtypim dhe ripërtypim gjëra të njohura e të stërnjohura me kohë...

Dituria mbarënjëzore i ngjan një muri vigan me një pafundësi gurësh të vendosur përkrah e përmbi njëri-tjetrit që, duke u parë nga larg, duket monolit e mitik, ndërsa kur i afrosh bëhet interesant, i bukur, shpirtërisht i afërt për gjithkënd e ku rrahin miliona zemra e mendime njerëzish të gjallë...

Kultura, artet dhe letërsia janë ndërtesa viganë, gurët e të cilave kanë bazamente të forta nga epoka në epokë, që i mban gjallë komunikimi, dhënie- marrja mes veti, duke bërë edhe riformësimin dhe rikrijimin... Një krijim i ri është si një gur që vendoset mbi supet e një të vjetri, që merr nga bazamenti gjithçka të mirë që i duhet, me mundësinë që të japë për atë që do të vendoset së shpejti sipër tij. "...ne shohim më larg se paraardhësit tanë, jo se kemi vështrim më të mprehtë apo se jemi më truphedhur, por se jemi ngjitur dhe qëndrojmë lart mbi shtatin e tyre vigan". (Xhoni i Salizburit, që i referohet Bernardit të Shartës)

1.1

Në botimet e shumta letrare, në krijimtarinë e shpërndarë dendur në rrjetet sociale, ka shumë ankesa të vazhdueshme të krijuesve për kopjime flagrante të krijimtarisë së tyre ose të të tjerëve, duke i quajtur ato plagjiatura, imitime, epigonizma etj. "Gjuha, që është ligjërimi më i vjedhur zakonisht prej mitit, bën një qëndresë të dobët". (R. Barthes)

Plagjiaturë vjen nga latinishtja *plagium* – kusari, vjedhje, hajni, hajdutëri; imitacioni – diçka e njëlojtë me diçka tjetër, e cila është marrë si gjedhe, kopje e origjinalit; epigon vjen nga greqishtja – i paslindur... Dukuri të tilla janë shfaqje të zhvillimit kulturor e letrar të kohërave, të kryera me vetëdije apo jo të krijuesve përkatës, akuzues dhe të akuzuar. Marrëdhëniet ndërkohore, me rimarrje e rishkruarje motivesh të njëjta prej mitesh, legendash, folklorit etj., janë të njohura tashmë. Mjafton që krijimtaria e prurë të sjellë kënaqësi estetike dhe njeriu të mësojë diçka të re prej saj...

Gjithçka që shkruhet e krijohet e ka një burim, nga diçka paraekzistuese; kush nga mitet, dikush tjetër nga ngjarjet historike, nga realiteti, nga librat e tjerë. Kujtojmë Iliadën e Odisenë, Komedinë Hyjnore, veprat e Shekspirit etj. Ku qëndron e reja që sjell një autor i vërtetë?! Sipas Horacit, e reja "...nuk qëndron në risinë e argumentit, por në proprie dicere (shprehjen e posaçme) në njoftimin origjinal, pra të ri, me karakteristika personale".

1.2

Për të shpëtuar nga akuzat për plagjiaturë, imitacione, epigonizma etj., prej vitësh autorët janë orvatuar të krijojnë me ose pa vetëdije rryma letrare nga më të ndryshmet, si simbolizmi, deri të modernizmi, postmodernizmi, për të qenë sa më "origjinale" në krijimtarinë e tyre. Kjo, sipas



tyre, bën diferencën. Realizmi u quajt i thjeshtëzuar, banal... Por, gjithsesi, komunikimi midis teksteve në letërsi nuk mund të mënjanohet kurrë plotësisht me procedime të tilla, si: ironia, parodia, analogjia etj. "Teksti është një kombinatore, vend i një shkëmbimi të vazhdueshëm ndërmjet copëzash që shkrimi i rishpërndan duke ndërtuar një tekst të ri nga tekste të mëparshme, tekste këto të shkatërruara, të mohuara, të rimarra". (Julia Kristeva)

Si ta kapërcejmë prirjen tonë për të qenë imitues ose epigone të paraardhësve tanë?! "Antidoti ndaj yshitjes për të imituar dhe për të kopjuar krijimtarinë e tjetrit, profilaksia ndaj epigonizmit, kërkon thellimin në erudicionin individual kulturor, leximin sistematik, leximin e vazhdueshëm, thellimin në arritjet e më të mirëve, punë këmbëngulëse dhe të palodhur për të gjetur vetveten, individualitetin e vet, kërkon një ndjenjë përgjegjësie ndaj lexuesve dhe patjetër, sedër dhe moral, etikë shembullore personale". (V. Ziko)


Në Kuriozitetet estetike Sharl Bodleri nënvizoi: "Artisti, artisti i vërtetë, poeti i vërtetë, duhet t'i paraqesë gjërat ashtu siç i sheh dhe siç i ndien vetë. Ai duhet t'i qëndrojë besnik natyrës së vet. Duhet të ruhet si prej vdekjes për të mos marrë sytë dhe ndjenjat e një tjetri, sado i madh qoftë ky; se atëherë arti i tij do të jetë gënjeshtër."

1.3

Mund të jepem me mijëra shembuj se si edhe vepra shumë të suksesshme të letërsisë e kanë një burim të sigurt ardhjeje. Midis të tjerash, nga këto burime mund të veçojmë dy: vepra të autorëve të tjerë dhe vepra pararendëse të vetë autorit. Në literaturë gjen plot shembuj se si veprat e Homerit, Shekspirit etj., vijnë nga mitet apo kronikat e kohërave të shkuara. Për rimarrje nga veprat e mëparshme shëmbëlajnë Pallati i ëndrrave, Piramida të I. Kadaresë; romani Oh i A. Pashkut nga tregimi Eklips i tij etj. "Krijimi i ri rikon poetin! Krijimi i ri prej lëndës së vjetër..." (L. Poradeci)

2

Duke studiuar krijimtarinë e shkrimtarit norvegjez Henrik Ibsen (1828-1906) më ranë në dorë një tufë vjershash interesante, ku bënte pjesë edhe poezia Zgalemi. Sapo e lexova, m'u kujtua proza e famshme poetike e M. Gorkit (A. M. Peshkov, 1868-1936), Kënga e Zgalemit ose Lajmëtari i furtunës, që e mësuam përmendësh që nga fëmijëria. Dhe vura re ngjashmërinë e madhe në përmbajtje midis këtyre dy krijimeve. Nisa të meditoj, pa e shkruar në mendje të fajësuj ndokënd, duke e quajtur këtë fenomen si përjetësim krijues...



Të dyja tekstet fillojnë me përshkrimin e zogut zgalem, "zog i qiejve dhe i detit"... Dhe arsytimet vazhdojnë.

2.1

Zgalemi i H. Ibsenit duket se është një vjershë e thjeshtë peizazheske-filozofike, me tone lirike, e ngjeshur në ide e domethënie, e shkruar në distikë (vargje dyshe), që bazohet në rrëfimet e një detari dhe që e krahason zgalemin në fund me "zogu-poet".

Kënga e Zgalemit e M. Gorkit, që është konsideruar edhe si Lajmëtari i furtunës, është po i njëjti peizazh, veçse më i larmishëm dhe më i zgjeruar në përshkrim. Aty Gorki ka futur shpirtin e vet rebel, kryengritës. Elementet shtesë janë vetëm shpendët e tjerë "inferiorë" në breg të detit, si çafkat, kredharakët e frikur, pinguini...

"Zgalemi i Gorkit është shpirti i atij njeriu që nuk mund të gjejë paqen në vulgaritetin e jetës, që nuk frikësohet si çafkat dhe as nuk fshihet si pinguini, por lufton e përballet me jetën duke synuar lirinë". (K. Stralla) Kjo prozë poetike komentohej dendur si thirrje e autorit për rebelim, në funksion të një ideali madhor, – komunizmit, – ideal utopik që ia hëngri kokën vetë autorit, pasi shkrimtari nuk e kuptoi atëherë se ky ideal nuk pati kurrë idealistë që ta vinin në jetë...

2.2

Duke qenë edhe vetë dramaturg, shkrimtar i shumë dramave interesante, M. Gorki e ka njohur me thellësi krijimtarinë e H. Ibsenit, kur ishte për disa vjet syrgjyn në Itali. Rrjedhimisht, e ka lexuar edhe vjershën Zgalemitë norvegjez të talentuar, prej nga e ka marrë edhe motivin shkrimor e shpirtëror. Edhe nëse nuk e ka pohuar se nga kush e ka marrë motivin, frymëzimin për të shkruar prozën poetike aq të njohur të tij, nuk mund të themi se ai është plagjiat, imitues apo epigon. Duke qenë shkrimtar i mirë, Gorki nuk mund të quhet një kopjacion i rëndomtë. Krijimi i tij ai i ka dhënë frymën gorkiane, e ka sjellë në kohën e vet dhe e ka veshur me fizionominë përkatëse. E ka ngritur artistikisht. Autorët marrin e japin me njëri-tjetrit, në frymë e në germë, mjafton që kjo marrëdhënie të jetë në dobi, në të mirë të letërsisë e të kulturës së mbarë njerëzimit...

2.3

ZGALLEM m. zool.

1. Shpend uji me pendë të bardha e të zeza, me krahë të ngushtë e të gjatë, me këmbë shumë të shkurtra, me bisht të bigëzuar dhe me sqep të kthyer, që fluturon mbi valët përpara e gjatë stuhisë. Zgalemi i stuhisë. Klithma e zgalemit. I guximshëm si zgalemi. 2. fig. poet. Paralajmërues i një lëvizjeje a i një ngjarjeje të madhe shoqërore. Zgalemi i revolucionit.

ZGALEMI

Nga Henrik Ibsen (1828-1906), përkthyer nga Shpëtim Çuçka

"Zgalemi jeton në shkëmb e në gur",  
më tha një detar i vjetër dikur.  
"Mes shkumës me krahë shkëlqen e këlthet,  
nuk mbytet jo kurrë, mbi valë rrëshqet.  
Luhatet ngadalë mbi det'n e pamatë,  
heshton në bunacë, këlthet në shtrëngatë.  
Her' zbret rrafsh me valët, her' ngrihet  
përpjetë,  
porsi ëndrrat tona nga toka në retë.  
I rëndë në ajër; i lehtë në det,  
ja gazi, ja vveri, ja zogu-poet".  
1858

KËNGA E ZGALEMIT

Kënga e Zgalemit ose Lajmëtari i furtunës, e shkruar nga Maksim Gorki (A. M. Peshkov, 1868-1936), përkthyer nga Lame Kodra (Sejfulla Malëshova)

Mbi të thinjurin shesh të detit era fryn dhe mbledhen retë. Midis reve edhe detit kryelartë shkon Zgalemi si e zezë vetëtimë.

Prek me krahë ai valët, si shigjetë ngjitet reve, dhe këlthet, dhe retë gjejiin gazin-klithmë të asaj shpese. Në atë klithmë e atë furtunë, Zjarr e flakë zemërimi dhe besimi në fitore gjejiin retë në atë klithmë.

Dridhen çafkat e rënkojnë, përmbi detin përpëlitën; janë gati ato të struken nga ky tmerr në fund të detit. Përpëlitën, si dhe çafkat, kredharakët e rënkojnë; nuk dinë ata të mjerët gëzim lufte, luftë jete; i tmerron ata gjëmimi. Ndër shkëmbinj mbulon i trembur trupn' e majmë pinguini...

Ngrihet vetëm kryelartë, me guxim, lirisht Zgalemi mbi të thinjurin det nga shkuma.

Gjithnjë më tepër ngryset, gjithnjë më poshtë zbresin përmbi detin retë e zeza dhe këndojnë e hidhen valët lart e drejt nga vjen rrufeja.

Bubullon. Rënkojnë valët: në atë shkumë zemërimi po luftojnë ato me erën. Turma valësh rremben era, i mbërthen ajo me forcë, i përplas me vrull shkëmbinjve, duke bërë çika-çika ato masa prej zumrudit. Po me klithmë shkon Zgalemi, si e zezë vetëtimë, si shigjetë i përpin retë, shkumën valësh heq me krahë. Si demon, ai vërtitet, madhështor e kryelartë ky demon i zi rrebeshi; qesh e qan ai njëherësh...

Qesh me retë, qan prej gazit. Në tërësimin e gjëmimit lodhje sheh e ndien demoni; ka besim zogu i furtunës; retë-diellin dot s' e fshehin! Era fryn me ulërimë... Bubullon e shkrep rufeja...

Ndizen retë flakë e kaltër përmbi detin si greminë. Kap shigjeta vetëtimash dhe në gji i shuan deti. Si gjarpërinj të zjarrtë dridhen mu në det e zhduken thellë pasqyrimet e atyre vetëtimave shigjeta. Ja furtuna! Vjen furtuna!

Kryelartë e trim Zgalemi shkon me vrull ndër vetëtima përmbi detin e tërësim, që buçet me ulërimë, dhe këlthet-profet fitoreje:

– Sa më tepër e fuqishme le të ngrihet lart furtuna! / *Exlibris*

# Aktorët që nuk kanë fituar asnjëherë Oscar

Ka disa arsye të vlefshme përse disa aktorë nuk kanë fituar ende një 'Oscar'. Më poshtë, mund të gjeni disa nga vëzhgimet dhe supozimet pse nuk ka ndodhur kjo.

Më poshtë gjeni 17 aktore dhe aktorë të talentuar të cilët janë nominuar për një 'Oscar' të paktën një herë, por nuk e kanë fituar këtë çmim akoma.

## 1. Amy Adams

Amy Adams është nominuar për 'Oscar' 5 herë për filma si 'Doubt', 'The Master' dhe 'American Hustle'. Në vitin 2016, ajo ishte e shkëlqyer në rolin e saj si Louise Banks në filmin "Sci-fi flick Arrival". Dhe ajo nuk u propozua as për një 'Oscar' për këtë pjesë, gjë që i bëri tifozët e saj të zemëruar.

Ndoshta arsyeja pse Adams ende nuk e ka fituar këtë trofe është sepse ajo ka filluar karrierën e saj në Hollywood në moshë të vonuar, ajo ishte tashmë 25 vjeç në kohën kur filloi të ishte pjesë e industrisë së filmit. Deri në këtë moshë, shumë yje janë nominuar për një 'Oscar' disa herë pasi është shumë normale të fillosh një karrierë në moshë të re. Por Adams ende ka shumë kohë për ta fituar këtë çmim.

## 2. Bradley Cooper

Bradley Cooper u nominua për një 'Oscar' tri vjet me radhë. Herën e parë ai u nominua në vitin 2013, kur ai u propozua për aktorin më të mirë për rolin e tij kryesor në "Silver Linings Playbook", por statuja shkoi në duart e aktorit Daniel Day-Lewis për performancën e tij në filmin "Lincoln". Vitin e ardhshëm, Cooper u propozua për "Aktorin më të mirë në rol dytësor" për filmin "American Hustle", por ishte Jared Leto i cili fitoi 'Oscar'-in atë kohë. Herën e tretë, ndërsa herën e tretë që ai u nominua, çmimin e fitoi Eddie Redmayne që luajti rolin e Stephen Hawking. Duket se Cooper nuk ka marrë ende mundësinë e tij të artë. Megjithatë, ai do të ketë një shans të vërtetë të mirë për ta lënë ceremoninë me çmimin në dorë këtë vit. Projekti i tij, "A star is born", ku ishte regjisor, producent, skenarist dhe aktori kryesor, është shumë premtues. Shpresojmë që ai do të fitojë këtë statujë të shumëpritur dhe të merituar.

## 3. Saoirse Ronan

Saoirse Ronan është vetëm 24 vjeçe, por tashmë ka marrë pjesë në garën për çmimin më prestigjioz të filmit tri herë. Nominimi i saj i parë u bë kur ajo ishte vetëm 13 vjeçe. Pastaj ajo ishte një nga kandidatët më të mirë të aktoreve për rolin e saj në filmin "Brooklyn", dhe vitin e kaluar ajo pothuajse fitoi çmimin për rolin e e saj kryesor në "Lady



Bird".

Ronan është një nga shembujt e një karriere të hershme. Por gjatë ceremonisë së vitit të kaluar, ajo kishte për të konkurruar me aktoret e mëdha si: Frances McDormand (60 vjeçe) dhe Meryl Streep (68 vjeçe). Ronan tha në intervistën e saj se ajo nuk është konkurrese për çmime dhe se vetë nominimi u ndje si një fitore ndaj saj. Ajo do të ketë një shans të mirë për të fituar një 'Oscar' këtë vit për rolin e saj si Mary Stuart në "Mary Queen of Scots".

## 4. Joaquin Phoenix

Joaquin Phoenix ka patur tri nominime për çmimin 'Oscar' deri më tani, dhe më i rëndësishmi ishte ai për "Aktorin më të mirë në rol dytësor" për filmin "Gladiator". Është e çuditshme, por ai kurrë nuk u nominua për rolin e tij të shkëlqyer në filmat si "Her" dhe "Inherent Vice".

Ka pasur zëra se Phoenix nuk dëshiron të marrë pjesë në këto ngjarje të pafundme dhe duhet të japë intervista të panumërta vetëm për t'u konsideruar për çmimin.

## 5. Helena Bonham Carter

Ky aktore është nominuar dy herë për një 'Oscar'. Herën e parë ndodhi në vitin 1998 kur ajo mori një nominim për "Aktoren më të mirë" për filmin "The Wings of the Dove". Herën e dytë, ajo ishte në vitin 2011 në kategorinë "Aktorja më e mirë në rol dytësor" për rolin e saj në dramën historike "The King's Speech". Mjerisht, në të dyja rastet, fati nuk ishte në anën e Carterit. Është interesante se ajo nuk fitoi asnjë çmim dhe nuk u nominua as për ndonjë gjë për punën e saj të jashtëzakonshme për rolin e Marlas në "Fight Club".

## 6. Johnny Depp

Gjatë gjithë karrierës së tij të gjatë Depp është nominuar për çmimin Oscar 3 herë. Në vitin 2004, nga të tre nominimet Deep nuk e fitoi asnjëherë këtë çmim. Depp thotë në intervistat e tij se ai nuk është i interesuar më për çmime. Ai ka thënë se, kurrë nuk donte të fitonte çmimin Oscar, duke e sqaruar se nuk mori pjesë për hir të fitimit të çmimit por për fansat e tij.

## 7. Sharon Stone

Sharon Stone ka luajtur në më shumë se 40 filma artistikë, por ajo u bë me famë botërore falë pjesës së saj në Basic Instinct. Sa për çmimin Oscar, ajo u propozua për këtë çmim vetëm një herë për pjesën e saj në Casino, por çmimi u fitua nga Susan Sarandon atë vit. Ajo u bë e famshme në moshën 34 vjeçare. Para se të niste këtë karrierë ajo punonte si modele dhe merrte pjesë në aktrim, në filmat B. Ajo nuk ndenji gjatë në SHBA, por zhvendosi vëmendjen e saj në Evropë. Thonë se është ajo që e bëri Festivalin e Filmit në Kanë një nga festivalet më të njohura dhe më të njohura të filmit në botë, e cila nuk është më pak prestigjioze sesa Çmimet e Akademisë.

## 8. Bill Murray

Ky aktor që është shuam i dashur nga miliona fansa, u nominua për çmimin Oscar vetëm një herë në 2004 në kategorinë e aktorëve më të mirë për pjesën e tij në Lost in Translation. Në atë kohë, ai humbi me Sean Penn. Është interesante që pavarësisht pjesëve që ka aktruar në filmat më të mirë, ai kurrë nuk ka fituar ndonjë çmim për ta. Në një nga intervistat e tij, Murray pranoi se ai kishte vendosur të mos merrte pjesë më në garën e Oskarëve. Ai krahasoi dëshirën për të fituar një Oscar me një virus që e pengon atë të mendojë qartë. Pasi nuk e fitoi Oskarën për Lost in Translation, ai tha, "6 muaj më vonë, kuptova se e kisha marrë virusin. Unë kam qenë i infektuar."



## 9. Keanu Reeves

Është e vështirë të besohet, por Keanu Reeves kurrë nuk është nominuar për një Oscar. Ai u bë i famshëm në mbarë botën pas filmave të suksesshëm si Speed and Point Break, dhe Matrix e bëri atë një figurë të famshme. Edhe pse ai nuk ka fituar çmimin Oscar, Reeves ka fituar vetëm çmime MTV Movie.

## 10. Tom Cruise

Tom Cruise u nominua për një Oskar në kategorinë e aktorëve më të mirë në vitin 1990 për herë të parë. Situata e Cruise-it mund të shpjegohet me një teori të quajtur Pitt-Hanks Continuum që thotë se ka dy lloje aktorësh në Hollywood. Tipi i parë i ngjan Brad Pitt, i dyti i ngjan Tom Hanks. Aktorët e tipit të parë vazhdimisht mund të shfaqin performancë të shkëlqyer, por ata kurrë nuk do ta fitojnë çmimin. Ndërsa aktorët e tipit "Hanks" mund të fitojnë një Oscar për punën e tyre të parë të suksesshme.

## 11. Jessica Chastain

Suksesi i vërtetë erdhi tek Jessica Chastain pas realizimit të filmit The Help. Ajo u emërua menjëherë për çmimin Oscar në kategorinë e aktorëve më të mirë. Megjithatë, ajo nuk fitoi trofeun e artë të atij viti. Vitin e ardhshëm ajo u propozua përsëri për filmin Zero Dark Thirty, por humbi me Jennifer Lawrence. Përveç kësaj, sipas Jessica, ajo tha se ajo ishte shumë e modës së vjetër në fillim të karrierës së saj. Aktualisht tani ajo është në kulmin e suksesit të saj, dhe ka një shans shumë të mirë për të fituar Oskarën e lakmuar në të ardhmen e afërt.

## 12. Will Smith

Është e vështirë të besohet, por Will Smith ka fituar shumë pak çmime serioze. Në të njëjtën kohë aktrimi i tij ka qenë gjithmonë i mirë, pa marrë parasysh se çfarë zhanri ka luajtur. Ai është emëruar dy herë për çmimin Oscar por në asnjëherë nuk e fitoi këtë çmim. Ndërsa në vitin 2016, Will dhe gruaja e tij Jada Pinkett Smith akuzuan Akademinë e Racizmit dhe u kërkuan njerëzve me ngjyrë të mos marrin pjesë

për çmimin Oscar.

## 13. Michelle Williams

Williams ka marrë pjesë katër herë në çmimin e Oskarit. Dy herë është nominuar në kategorinë e aktorëve më të mirë për dy filmat e saj. Ndërsa 2 herë të tjera ajo u propozua për Best Supporting Actress në filmat Brokeback Mountain dhe Manchester by the Sea. Por pavarësisht të gjitha këtyre filmave ajo nuk arriti të fitonte trofeun e Oskarit. Kohët e fundit, aktorja ka vendosur të kalojë nga role të thella dhe dramatike në projekte më të thjeshta si Feel Pretty dhe Venom.

## 14. Keira Knightley

Keira ka luajtur në shumë filma të suksesshëm dhe ka qenë e nominuar dy herë për një çmimin Oscar. Emërimi i parë u zhvillua në vitin 2006, për pjesën e saj në Krenari dhe Paragjykimet. Herwne dytë është dominuar në 2015, për pjesën e saj në dramën historike The Imitation Game.

## 15. Robert Downey Jr

Gjithashtu edhe situata me Robert Downey Jr duket e padrejtë. Ai u propozua për herë të parë për çmimin Oscar shumë kohë më parë në vitin 1993 për aktorin më të mirë në Chaplin, por nuk fitoi. Hera e dytë dhe e fundit ishte në vitin 2009 kur ai u emërua në kategorinë e aktorëve më të mirë për Tropic Thunder, por nuk fitoi. Kohët e fundit ai ka thënë se në moshën e tij j 53 vjeçare, do të dukej patetik me një një kostum superhero.

## 16. Glenn Close

Shumë njerëz e njohin Glenn Close për pjesën e saj si Cruella De Vil në filmat e 101 Dalmateve. Por shumë pak janë të vetëdijshëm se Close është nominuar për një çmimin Oscar 6 herë gjatë karrierës së saj 36-vjeçare. Vlen të përmendet se nominimet e saj të para, 5 prej tyre u zhvilluan në vitet 80. Emërimi i saj i fundit u zhvillua në vitin 2012 për rolin e saj si Albert Nobbs në Albert Nobbs. Ndoshta, aktorja ka qenë e pafat me konkurrenset e tjerë sepse ajo ka dalë kundër, duke humbur me aktoret si Jessica Lange, Cher dhe Meryl Streep.

## 17. Brad Pitt

Askush nuk do ta besojë se Brad Pitt nuk ka fituar akoma çmimin Oscar. Pranimi i parë i Pitt u zhvillua në vitin 1996 për pjesën e tij në filmin Dymbëdhjetë Majmunët. Hera e dytë ishte në vitin 2009 për pjesën e tij në The Curious Case of Benjamin Button, por sërish nuk fitoi. Në vitin 2012, Brad Pitt kishte edhe 2 nominime për aktorin dhe producentin më të mirë dhe fitoi çmimin "Best Picture Academy Award" por humbi përsëri Oskarën.

# Shiu dhe 'Qyteti në depresion' i Bardhyl Londos

“Poezia nuk ka nevojë për ndjekës, por për të dashur”, thotë poeti i madh Federico García Lorca. Dhe unë, si njeri që ushqehem me poezinë dhe e kam të domosdoshme si ajrin e detit, me të cilin jam rritur, nuk mund të rri pa thënë dy fjalë për “Qyteti në depresion”, një poezi që e desha, sapo e lexova, si dashuria me shikim të parë.

Edhe kjo poezi, ashtu si poezitë e tjera të mjeshtër Bardhyl Londos, është me shumë plane dhe ambigue. Ambiguiteti në këtë poezi është më i theksuar se në poezitë e mëparshme të tij, madje dhe dikotomia. Po ta shikojmë me kujdes fjala kyçe në këtë poezi është fjala “shiu”. Ajo që bije në sy është përmendja e të gjitha vendeve kryesore të kultit në kryeqytet: Katedralja Protestante, Katedralja Ortodokse, Katedralja Katolike dhe Minarja e Xhamisë.

E dimë se shiu është një dukuri natyrore shumë e rëndësishme për jetën e njeriut dhe natyrën. Por në besimet e Krishtera reshjet e shiut përfaqësojnë rilindjen dhe spastrimin emocional. Të krishterët përdorin ujë për pagëzime për të simbolizuar vdekjen shpirtërore dhe ringjalljen. Me fjalë të tjera, është një simbol i qartë për lindjet shpirtërore, pastrimin dhe larjen e mëkateve. Edhe në fenë islame, uji paraqet jetën, të lindurit, pastërtinë. Në Suren Furkan (Kuran, dallues të së vërtetës nga e pavërteta) thuhet pikërisht: “Ne lëshuam prej qiellit ujë të pastër.

Që me të t'i japim jetë një toke të vdekur dhe që t'u japim të pinë atyre që i krijuam, kafshë e shumë njerëz.” Ajo që është mbresëlënëse në poezinë “Qyteti në depresion” të Bardhyl Londos është fakti se ashtu si shiu nuk bën asnjë dallim midis të pasurit dhe të varfrit, midis mëkatarit dhe të devotshmit, shiu i Bardhyl Londos rreh dhe lag njësoj të gjitha vendet e kultit, pra e çon në një nivel ndëshkimin apo drejtësinë që vjen nga lart. Këtu vjen një kthesë e madhe në poezi dhe kuptohet që nuk kemi një ndëshkim të zotit, por kemi ndëshkim nga robi, prej të cilit kemi këtë gjendje:

*“e Premtja e Zeze edhe më zezon,  
shiu zbret si një antikrisht i zi sterrë,  
gjysma djallëzi, gjysma depresion.”*

Futja e simboleve fetarë në këtë kontekst tregon, jo vetëm rëndësinë e kësaj gjendjeje, por dhe mashtrimin e atyre që po dalin sikur janë shpëtimtarët, por në fakt janë antikrishti. Po rikujtoj një pasazh nga Bibla: “Sepse do të dalin krishterë të remë dhe profetë të remë dhe do të bëjnë shenja e mrekulli të mëdha për të



mashtuar, po të jetë e mundur, edhe të zgjedhurit”. (Mateu 24:24, NKJV)

Shiu i Bardhyl Londos në varësi të kontekstit në të cilin shfaqet, nuk simbolizon vetëm trishtimin, ankthin, makthin, refuzimin ose dëshpërimin, por dhe mashtrimin, që mund të vijë pambarim si pikat e shiut. Nuk është e pamundur të mos ndodhë kjo gjë me kaq shumë mjete informacioni që përdoren për propagandë të “krishterëve të remë”. Shiu i natyrës, pra ai i vërtetë, zvogëlon rrezet e diellit duke shkaktuar emocione dhe gjendje të forta shpirtërore deri depresion nga errësira. Shiu, për të cilin flet poeti Bardhyl Londo ka shkaktuar terr informativ kur thotë se “vetëm më të rrallë ndonjë e-mail enigmë / eterin çan nëpër depresion.” Në letërsi, shiu shpesh përdoret në mënyrë metaforike për të shfaqur pakënaqësi ose gjendje shpirtërore të rënduar. Shumë poezi me pikat e shiut simbolizojnë lotët e njeriut. Letërsia ka një ndërthurje të pasur simbolesh të lidhura me shiun. Poetë e shkrimtarë të ndryshëm e kanë përdorur shiun si simbol në veprat e tyre letrare dhe një prej tyre është dhe poema “Tokë e Shkretë” e T. S. Eliot, e konsideruar botërisht si një nga poemat më të rëndësishme të shekullit të 20-të dhe një vepër qendrore e poezisë moderniste. Ashtu si në poemën “Tokë e Shkretë” të TS Eliot, edhe në poezinë “Qyteti në depresion” të Bardhyl Londos, lexuesi vëren ankthin e njeriut mbi vdekjen dhe marrëdhënien e tij me elementët fizikë të tokës, siç është shiu, apo uji.

S.T Eliot poemën “Toka e Shkretë” e hap me vargjet e famshme : “Prilli është

muaji më i egër, ngjall / Jargavanët që brenda tokës së vdekur”, ndërsa Londo flet se në këtë atmosferë prilli, (sepse zakonisht e Premtja e Zeze, ndodh në prill,) ndodhin këto gjëra, që tregojnë degradimin moral:

*“Drogaxhinj të papunë, prostituta që shfryjnë,  
pa një ftesë orgjie, pa një telefon,  
qiellit enden ca lakuriqë nate,  
gjysma enigmë, gjysma depresion.”*

Në pjesën e katërt të kësaj poeme me nëntitull “Vdekja nga Uji”, Eliot na kujton vdekshmërinë tonë dhe na kërkon të rivlerësojmë marrëdhëniet tona me vdekjen, pavarësisht se kush jemi, po këtë gjë e bën në mënyrë metaforike krejt origjinale poeti Bardhyl Londo duke marrë elementë të situatës pandemike, në të cilën ndodhemi:

*“Balli i kryeqytetit digjet furrë,  
trupit dridhet nga ethe deri natën von,  
larg, në periferi, dy varrezat civile  
shiu i lag pa mëshirë me depresion.”*

Në këtë rast shiu është bashkudhëtar i një gjendjeje shpirtërore të rënduar dhe ka simbolikën e lotëve. Në këtë strofë të fundit shiu ka funksion psikologjik dhe është metaforë ekspansive.

Një shi të tillë, që shfaqet pandërprerë si te poezia “Qyteti në depresion”, e gjejmë te romani “Lamtumirë Armë” të Ernest Hemingway, ku ai shfaqet të bjerë përgjatë gjithë romanit dhe simbolizon lotimin e personazheve, dhimbjen që përjetojnë për shkak të ngjarjeve të tragjike në jetën e tyre. Madje personazhi kryesor i romanit, mbas vdekjes së njeriut të dashur, largohet

nga spitali dhe ecën nëpër shi për të shkuar në shtëpi.

Futja në poezi nga ana e poetit Bardhyl Londo edhe e kineastit Hitchcock, i cili është i njohur si “Mjeshtri që të mban pezull”, i jep nota të forta ankthi lexuesit dhe tregon për një situatë kritike, në udhëkryqin e mbytur nga “pavijoni”.

Si nga forma, ashtu edhe nga përmbajtja poezia “Qyteti në depresion” është e mirorganizuar. Rimat në vargun e dytë me të katërt krijojnë një jehonë dhe një përsëritje vrastare si shiu apo si kambana mortit. Madje fjalët “von” e “depresion”, të përsëritura si fjalët “nevermore” (asnjëherë) dhe “Lenore” të poemës “Korbi” të Edgar Allan Poe, të ndërthurura me fjalë me nënkuptime filozofike, ose simbolikë dhe shëmbëlltyra fetare, i japin tone drithëruese poezisë. Në këtë rast forma është në funksion të përmbajtjes dhe të dyja plotësojnë njëra-tjetrën për ta dhënë më të plotë mesazhin poetik.

Por ndryshe nga ankthi i Dantes te “Komedia Hyjnore”, apo i Edgar Allan Poe te “Korbi”, që janë ankthe personale, këtu flitet për një ankth dhe çmenduri kolektive në një vend konkret, që nënkuptohet nga emri i lagjes periferike “Laprakë”. Kjo e bën poezinë kontribuuese në shërbim të komunitetit sepse brenda saj gërshetohen e bukura, e mira dhe e vërteta, ashtu siç thotë dhe poeti anglez Dylan Thomas se “Një poezi e mirë është një kontribut ndaj realitetit. Bota nuk është asnjëherë njësoj pasi asaj i është shtuar një poezi e mirë. Një poezi e mirë ndihmon për të ndryshuar formën e universit, ndihmon për të zgjeruar njohuritë e secilit për veten dhe botën përreth tij.”

**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Enveri  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE  
'BUJQËSIA'  
TEL: 045/82 82 82**

# Shabani: Ndaj Flamurtarit, përveç fitores, çdo rezultat është dështim

Mesfushori Bujar Shabani ka thënë të premten për "Epokën e re" se Drita synim të vetëm në ndeshjen ndaj Flamurtarit e ka fitoren. Sipas tij, çdo rezultat tjetër është dështim për klubin gjilanas. "Tash jemi para ndeshjes së parë dhe do të luajmë në fushën tonë ndaj një kundërshtari mjaft të mirë, por ne do të hyjmë vetëm për fitore për faktin se jemi në garë për titullin e kampionit. Çdo rezultat tjetër përveç fitores do të ishte dështim për klubin tonë", ka thënë Shabani



**EPOKA E RE** **Veton ZYMBERI**

**PRISHTINË, 5 QERSHOR** - Skuadra e Dritës së Gjilanit sot (e shtunë) e zhvillon ndeshjen e parë në IPKO Superligën e Kosovës në futboll pas pauzës së gjatë për shkak të pandemisë Covid-19. Klubi i Dritës është në garë për titullin e kampionit dhe në ndeshjen e radhës kundër Flamurtarit synim të vetëm e ka fitoren. Kështu ka bërë me dije Bujar Shabani të premten për "Epokën e re". Mesfushori me përvojë të madhe e ka vlerësuar skuadrën kundërshtarë shumë të vështirë, por beson se të tria pikët mbesin në Gjilan. "Kemi filluar përgatitjet që tri javë dhe mendoj se jemi mirë në aspektin fizik, pasi edhe gjatë pandemisë përmes programit që na ka dërguar klubi jemi munduar ta zbatojmë me aq mundësi sa kemi pas mundësi. Tash jemi para ndeshjes së parë dhe do të luajmë në fushën tonë ndaj një kundërshtari mjaft të mirë, por

ne do të hyjmë vetëm për fitore për faktin se jemi në garë për titullin e kampionit. Çdo rezultat tjetër përveç fitores do të ishte dështim për klubin tonë", ka thënë Shabani.

Skuadra e Dritës nga 22 xhirot e zhvilluara ka grumbulluar 43 pikë dhe zë vendin e dytë pas Ballkanit që është në vendin e parë. Klubi gjilanas synon që të shpallet kampion dhe të fitojë të drejtën për pjesëmarrje në garat parakualifikuese të Ligës së Evropës.

Sot (e shtunë) në kohë të njëjtë me ndeshjen Drita - Flamurtari zhvillohet edhe përballja tjetër mes Feronikelit dhe Vushtrrisë. Tri ndeshjet e tjera për xhiron e 23-të në IPKO Superligë zhvillohen të dielën.

## Llapi, bindës ndaj Dukagjinit

Llapi e ka fituar pa asnjë problem përballjen me skuadrën e Dukagjinit (4-1) në ndeshjen e parë pas kthimit të futbollit nga

pandemia. Klubi vendas kaloi në epërsi në minutën e tretë me golin e shënuar nga Elvis Preniçi. Me këtë rezultat përfundoi pjesa e parë e ndeshjes, derisa tre minuta pasi filloi pjesa e dytë, Llapi shënoi edhe golin e dytë nëpërmjet Kastriot Selmanit. Në minutën e 51-të, Dukagjini e ngushtoi epërsinë në 2-1 me golin e Erlind Mulaj, kurse për më pas shënuan Erlis Ymeri (72') dhe Valmir Velu (90+). Pas kësaj ndeshje Llapi ka grumbulluar 37 pikë, kurse Dukagjini mbetet në kuotën e 10 pikëve.

### IPKO SUPERLIGA

**Llapi - Dukagjini 4-1**

**Të shtunën takohen:  
16:00 Feronikeli - Vushtrria  
16:00 Drita - Flamurtari**

**Të dielën takohen:  
16:00 Gjilani - Trepça '89  
16:00 Ballkani - Drenica  
18:00 Prishtina - Ferizaj**

### SHKURT

#### Përfundon sezoni për Përparim Islamin

Në ndeshjen gjysmëfinale të Kupës së Kosovës në futboll ndaj FC Ballkanit në Suharekë, mbrojtësi i skuadrës së Feronikelit, Përparim Islami, pësoi një lëndim që e detyroi të largohet nga fusha. Pas rezultateve është konfirmuar se sezoni ka përfunduar për Islamin. "Islami, pas testeve të bëra dje dhe ekzaminimit me rezonancë magnetike sot, ka konfirmuar se ka këputur ligamentin ACL, në gjurin e tij të djathtë. Ai do t'i nënshtrohet operimit ditëve në vijim me shpresën që të kthehet në fushë sa më shpejt që të jetë e mundur. Islamit i urojmë shërim sa më të shpejtë dhe mezi presim ta kemi sërish në stërvitje e në ndeshje", thuhet në njoftimin e Feronikelit.

#### Rashica shihet si zëvendësues i Wernerit

Ylli i Përfaqësueses së Kosovës, Milot Rashica, mund ta zëvendësojë Timo Wernerin në Leipzig. Klubi gjerman ia ka vënë syrin Rashicës, i cili ka treguar formë të mirë me skuadrën e Bremenit. Në anën tjetër Werner mund t'i bashkohet Chelsea. Klubi aktual e vlerëson vushtrriasin 38 milionë euro, por nëse Werderi bie nga liga, çmimi i futbollistit kosovar do të bjerë për 15 milionë euro. Rashica kërkohet edhe nga Borussia Dortmund, Liverpooli, Aston Villa, Wolverhamptoni, Lazio dhe Napoli.

#### Çmimi i lartë i Kumbullës, pengesa e vetme për transferim tek Interi

Marash Kumbulla vazhdon të jetë një nga emrat më të përfolur në futbollin italian. Kumbulla mbetet objektivi kryesor për Interin në mbrojtje, por për momentin pengesë bëhet kërkesa financiare për kartonin e 20-vjeçarit. Verona kërkon 25 milionë euro për shqiptarin, për të cilin në garë janë edhe Napoli, Lazio dhe Juventus.

#### Futbollisti Elbasan Gashi largohet nga Ballkani, shkon në Itali

Futbollisti Elbasan Gashi është larguar edhe zyrtarisht nga skuadra e Ballkanit, pasi ai tash e tutje jetën do ta vazhdojë në Itali. Klubi i Ballkanit e ka përshëndetur futbollistin në mënyrë dinjitoze dhe e ka njoftuar se dyert e klubit gjithmonë janë të hapura për të. "Në hapësirat e FC Ballkani përplot emocione të përziera, me rastin e përshëndetjes nga futbollisti Elbasan Gashi, i cili gjithë karrierën futbollistike e kaloi në klubin e qytetit të tij, duke djersitur fanellën në kohët e vështira, por edhe në kohë më të mira, e që është karakteristikë për Elbasanin. Ai gjithnjë ka ngelur i njëjti duke respektuar fëmijët e shkollës së futbollit, zbatuar udhëzimet e stafit teknik, duke ndërtuar raporte të afërta dhe të dashura me tifozët, e në veçanti tifo grupin "Xhebraliat". Në fushë Elbasanin e respektonin edhe kundërshtarët pasi që me sjelljen e tij e meritonte, një shembull model si duhet të jetë një futbollist në fushë dhe jashtë saj", thuhet në njoftimin e Ballkanit.

## Brawn: Kampioni mund të shpallet edhe me tetë gara në Formula 1

LONDËR, 5 QERSHOR - "Në teori, tetë garat e programuara deri më tani në Evropë mund të mjaftojnë për ta shpallur kampionin e botës për këtë sezon në Formula 1". Ka qenë kjo deklarata surprizë e Ross

Brawnit, drejtorit sportiv të Formulës 1 për "Autosport". "Nuk ishte e lehtë të programohej këto 8 gara të para në Evropë, pasi 2-3 javë më parë kjo gjë dukej e pamundur. Gjithsesi, tani kemi një kalen-

dar", ka thënë Brawn. Në lidhje me mundësinë për të shtuar gara të tjera në botëror, Brawn ka deklaruar: "Situata ndryshon shumë shpesh, edhe pse po përmirësohet. Ka shtete ku ne duam të garojmë,

por situata është ende problematike si Meksika apo Brazili. Kemi shumë opsione në tavolinë pas 6 shtatorit. Mendoj se mund të ndërtojmë një kalendar të mirë dhe të bëjmë një sezon të denjë".



## Shënohet 5 qershori, Dita Botërore e Sportit dhe Mjedisit


PRISHTINË, 5 QERSHOR - Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Vlora Dumoshi, pas rimarrjes së mandatit, ka vazhduar aktivitetet në kuadër të realizimit dhe përmbushjes së planit dhe objektivave që ka si ministere, në përputhje të agjendës që ka MKRS-ja për këtë vit.

Ministria Dumoshi mori pjesë në aktivitetin e organizuar nga Komiteti Olimpik i Kosovës për ta shënuar 5 qershorin - Ditën Botërore të Sportit. Me këtë rast ministria Dumoshi u shpreh se pas rimarrjes së mandatit si ministere në MKRS në qeverinë Hoti do të vazhdojë të punojë me përkushtim dhe do të

bashkëpunojë në interes të avancimit të fushave që janë në përgjegjësinë e ministrisë që ajo udhëheq. "Bashkërisht do të punojmë shumë, sidomos për sportin, sepse nuk do të kemi sport të shëndetshëm nëse nuk do të kemi një mjedis të pastër. Ky mesazh është i mirë se çdo qytetar të mbjellë më shumë pemë dhe ta fisnikërojë natyrën tonë. I ftoj të gjithë qytetarët që secili prej tyre nëpër komuna ta japin mesazhin më të mirë për ruajtjen e ambientit për ta bërë një Kosovë sa më të pastër", u shpreh ministria Dumoshi pasi mbolli një pemë olimpik bashkë me kryetarin e Komitetit

Olimpik të Kosovës, Besim Hasani, si simbolikë për të shënuar këtë ditë të rëndësishme për sportin.

Po ashtu, ministria Dumoshi ka thënë se: "Do të diskutohet edhe në mbledhjen e Qeverisë për Pakon Emergjente që do t'u dalë në ndihmë sportistëve". Ndërkaq kryetari i Komitetit Olimpik të Kosovës, Besim Hasani, ka thënë se: "Sot është Dita Botërore e Sportit dhe Mjedisit, edhe Komiteti Olimpik i është bashkangjitur kësaj dite dhe nga kjo mbjellje ne duam ta dërgojmë mesazhin që të mbillet në kokën e secilit të ri ajo fara për përkujdesjen e mjedisit dhe të ambientit".



## Modriç: Ronaldo ishte afër të qante pas kritikave të Mourinhos

MADRID, 5 QERSHOR - Ish-fituesi i "Topit të Artë" në vitin 2018, Luka Modriç, rrëfen në librin e tij biografik një episod ku ish-trajneri i Real Madridit, Jose Mourinho, debatoi ashpër në një ndeshje me Cristiano Ronaldon. Në librin "Loja ime" mesfushori veteran kroat tregon se pas përfundimit të pjesës së parë të një ndeshjeje të Realit në Kupën e Mbretit, Mourinho

kritikoi ashpër bashkëkombësin Ronaldo. Madje Modriç pretendon se portugezi u prek aq shumë sa ishte gati të qante. "Reagimi i Mourinhos më befaso. Po fitonim 2-0 në Kupën e Mbretit. Ronaldo nuk e ndoqi shokun e skuadrës pas një rivënieje me duar dhe Jose u acarua me Ronaldon. Të dy debatuan gjatë në fushë. Kur u kthyem në dhomat e

zhveshjes, e pashë Ronaldon të mërzhitur, gati të qante. Ai tha: 'Po jap më të mirën dhe ai akoma më kritikon'. Mourinho erdhi dhe filloi ta kritikonte Ronaldon për përgjegjësinë që duhej të mbante në fushë. U acarua situata aq shumë sa që u detyruan lojtarët të ndërhynin dhe ta shmangnin sherrin", ka rrëfyer Modriç në biografinë e tij.

### SHKURT

#### Ajdini firmos kontratë profesionale me Servetten

Futbollisti Alban Ajdini ka bërë hap të madh në karrierë duke firmosur kontratë profesionale me klubin e Superligës së Zvicrës, Servette. Ajdini, që me prejardhje është nga Kosova, është prodhim i Akademisë së Servettes. Ai është bashkuar me këtë skuadër në moshën pesëvjeçare. Ka kaluar të gjitha grupmoshat dhe tashmë është në derë të ekipit të parë. "Servette është e lumtur me nënshkrimin dhe i dëshiron lojtarit të ardhme të ndritur", thuhet në komunikatë.

#### Sadiku nuk largohet nga Malaga

Armando Sadiku do të vazhdojë të jetë pjesë e Malagës, të paktën deri në fund të këtij sezoni, i cili do të luhet edhe gjatë verës për shkak të pezullimit disamujor nga pandemia. Pikërisht sulmuesi shqiptar, i cili luan i huazuar te Malaga nga Levante, së fundmi ka bërë një gjest shumë të mirë për t'i ardhur në ndihmë klubit të tij. Sadiku ka arritur marrëveshjen me drejtuesit e Malagës, që të vazhdojë të jetë pjesë e skuadrës të paktën deri në fund të sezonit, ndonëse kontrata e tij me këtë klub përfundon më 30 qershor. Gjithashtu, ai ka pranuar se pas 30 qershorit të mos kërkojë pagë, duke parë edhe problemet e klubit.

#### Chelsea ia rrëmben Wernerin nga duart Liverpoolit

Timo Werner me shumë mundësi do të luajë në Premierë Ligë sezonin e ardhshëm, por jo te Liverpooli. Sipas gazetës "Bild", Chelsea punuar në qetësi dhe pa zhurmë për ta bindur futbollistin gjerman. Liverpooli duket se nuk ka ndërmend që ta paguajë klauzolën e tij sipas asaj që shkruan prestigjiozja gjermane. Trajneri Jurgen Klopp dhe sulmuesi kanë pasur bisedime personale, pasi dëshira e Wernerit për të kaluar në "Anfield" njihet tashmë. Frank Lampard po shfrytëzon stepjen e "Redsave" dhe është gati ta paguajë klauzolën e lirimit të Wernerit. Chelsea do ta bindë futbollistin me një rrogë të majme prej 10 milionë eurosh në sezon dhe një kontratë pesëvjeçare.

#### Lëndimi i Messit nuk është serioz

Ylli argjentinas Lionel Messi kishte pësuar një lëndim ditën e martë, duke u raportuar se mund ta humbasë ndeshjen e parë pas rifillimit të La Ligas kundër Mallorcës. Skuadra e Barcelonës përmes një njoftimi ka bërë me dije se Messi ka pësuar një lëndim në këmbën e djathtë dhe është duke u stërvitur në mënyrë specifike. Nuk dihet nëse ai do të jetë në gjendje të luajë kundër Mallorca, por mediat në Spanjë kanë raportuar se gjashtë herë fituesi i "Topit të Artë" do të rikuperohet me kohë. Lionel Messi është golashënuesi më i mirë i këtij sezoni në La Liga, me 19 gola të shënuara.

#### Khedira: Ëndrra ime është të fitoj LK-në me Juventusin

Triumfi në garën e Ligës së Kampionëve me Juventusin është ëndrra e mesfushorit të Kombëtares së Gjermanisë, Sami Khedira. "Ëndrra ime është të fitoj Ligën e Kampionëve me Juventusin. Ne u afruam para tre-katër vjetësh në finalen kundër Real Madridit. Mendoj se mund ta fitojmë Ligën e Kampionëve me Juventusin gjatë viteve të ardhshme dhe nuk është vetëm ëndrra ime, por edhe ajo e tifozëve 'Bianconerë'", ka thënë Khedira, i cili gjatë karrierës futbollistike ka luajtur edhe për Real Madridin dhe Shtuttgartin.

	<b>Autor: GAZMEND MORINA</b>										BIMË BARISHTORE NJËVJEÇARE, ME KËRCELL TË GJATË (sh.shq.)	SHUMË I LODHUR, KËPUTUR	EMËRORE, RASA E PARË E LAKIMIT (gram.)	LLOJ PAPA-GALLI	FUTBOLLISTI ALTIN ....	SHTET I LASHTË NË EVROPE	NJË NGJYRË	I ÇMPREHE	ME VËSHITËRËSI, ME SHUMË MUNDIM	<b>EPOKA E RE</b>	PJESË E MEKANIKËS QË STUDIOJ LIGJET E LËVIZJES SË TRUPAVE			
	MBARIM, PËRFUNDIM																			BASHKËTING. TEFIK OSMANI				
	PAMORAL-SHMËRIA																							
	SHTET NË AFRIKË (pashq.)														GAZ QË PËRDORËT PËR TË PASTRUAR PLAGËT ANA MERO									
	REGJISORI GJERMAN ... EDEL QYTET I YNI										ZEZAKU; I ZIU ISH BENDI MUZIKOR ANGLEZ "..... KITTEN"										ZANORE RRJET I QARKULLIMIT TË AUTOMJETEVE			
	PIKTORI YNË ... VALLA													PËREMËR PRONOR							DY BASHKËTINGËLLORE RRYMË AJRI QË LËVIZ NË DREJTIME TË NDRYSHME			
	KUJDESTAR (lat.)														KA A DEM I PATREDHUR MARKË E TELEFONAVE CELULAR									
<b>EPOKA E RE</b>	KËNGËTARJA KANADEZE NË FOTO LAVIGNE	KRYEQYTETI I NJË SHTETI EVROPIAN	ZBAVITËS, TËRHEQËS	NIKEL	KUFI	ZANORE	QYTET NË ITALI MALËSOR													"F" në mes të dy "A" PRAROJ				
GRADIM, PËRPARIM	○																				ZANORE MARRJE E TIPAREVE TË PARAARDHËSVE TANË	PËRGËZIM		
QYTET NË KOSOVË	○						ALYSA MILANO MOR, HEJ (pashq.)					BIMË QË BËN KOKRRA TË THARA (shq.) ENDACAKE												
RENIUM, REOMIR	○				SKLLAV I LIRUAR (hist.) FUTBOLLISTI BRAZILIAN .... SILVA (MILAN)								NOTË MUZIKORE KALORËS MESJETAR			OHAJO, LUIZIANA AKTORI YNË ... HAZIRI					BASHKËTING. KËNGËTARJA SHQIPTARE ANILA .....			
ZEMËRIM, EGËRSIM	○					PJESË RROTULLUESE E NJË APARATI MITRUSH KUTELI							SHKOLLIMI, ARSIMIMI (bised.) ARKIVI I FILMAVE											
LAKESË	○													ZANORE BASHKËTING.							SHTEG SECILA NGA PJESËT E NJË NDRËTËSE (pashq.)			
<b>EPOKA E RE</b>	QESËNDISJE	KËNGËTARJA ANITA ... TMERR						ZYRTARIZIM I NJË MARRËVESHJE NDRËKOMBËTARE BURIMI														SMIRË		
I DOBËT, TINËZAR								BENDI MUZIKOR "IRON ...." PËRMBLEDHJE E SISTEMUAR UDHËZIMESH (shq.)														SHPEND I EGËR ME BISHT TË GJATË DETERGJENT PËR DUAR		
SHFUQIZIM I NJË AKTI JURIDIK																						KËNGËTARJA JONË ... SHKODRA BASHKËTING.		
OMANI, BENINI			FUTBOLLISTI BEHRAMI			BASKETBOLLISTI TURK OMER ... AKTORI FRANÇEZ DELON (shq.)						MODELJA SHQIPTARE FEJZULLAHU	GOTË PREJ METALI BASHKËTING.									SHOK, JARAN GJELLË E PËRGATITUR VETËM ME ORIZ		
SHTET FEDERAL NË SHBA									MYNXYRË; HALL I MADH AI QË E KISHTE DOBËSI THEMBREN								PESCARA, IVREA AKTORJA ME FAMË BOTËRORE ... REID					ZANORE SHTRESË E SIPËRME E AJRIT		
SHTET NË EVROPE (pashq.)									"R" pas dy "A" AKTORJA ME FAMË BOTËRORE ... FARIS				ARKË SHUMË E VOGËL PREJ KARTONI									ERBIUM EUROPEAN TRAIN ENTHUSIAST		
KAMBANË FARE E VOGËL							BOSHTI ARIAN MALIQI							JETËSHKRIM (sh.shq.) DY BASHKËTINGËLLORE								TONY ANDERSON		
ZANORE		MËNYRË ARTIFICIALE E EPSHIT ISLANDA																					PASURITË E PATUNDSHME QË SILLNIN TË ARDHURA URUGUAI	
I ULËT E I TILLË SA MË S'BËHET																							FILLIMI I AGIMIT	
ZGJIDHJA E FJALËKRITIKUT: FINALIZIMI, AMORALITETI, SOMALI, EROS, TINA, OB, ONAN, TAS, MIK, NEVADA, GAZEP, PI, A, ITALI, AAR, KUTI, ER, ZILE, AKSI, VINONA, I, VITIA, AM, KIKIRIKU, RER, KOLON, MI, OL, R, INAT, ROTOR, ARSIMI, LAKIM, KOMIK, A, RIM, TAKE, RATIOKIM, I, LIG, MAIDEN, FAZAN, REVOKIM, EROS, TINA, OB, ONAN, TAS, MIK, NEVADA, GAZEP, PI, A, ITALI, AAR, KUTI, ER, ZILE, AKSI, VINONA, I, VITIA, AM, KIKIRIKU, RER, KOLON, MI, OL, R, INAT, ROTOR, ARSIMI, LAKIM.																								



### KOMPANIA REGJIONALE E MBETURINAVE "UNITETI" SH.A MITROVICË

Duke u bazuar në nenin 7 dhe 8 të Ligjit të Punës (Ligji Nr.03L/212), Vendimit të Bordit të datës 12.02.2020 për shpalljen e konkursit, gjendjes momentale dhe nevojave të Kompanisë për plotësimin e vendeve të punës për periudhën e ardhshme një vjeqare, KRM "Uniteti" SH.A vendosi që me datë 06.06.2020 të ri-shpallë:

#### KONKURS PUBLIK

Për plotësimin e vendit të punës:

**Receptionist/e** -Njësia nw Skenderaj me kohë të caktuar (me kohëzgjatje 1/një vjeqare), me mundësi vazhdimi

#### Detyrat kryesore dhe përgjegjësitë:

- Përgjigjet në thirrjet telefonike, përcakton qëllimin e tyre dhe i transferon, përcjell ato tek zyrtarët përkatës;
- Përgjigjet pyetjeve lidhur me Kompaninë dhe orienton palët për realizimin e kërkesave të tyre si dhe jep informacione tjera;
- Pranon informatat përmes telefonit dhe faksit dhe i përcjell ato tek zyrtarët përkatës;
- Mirëpret vizitorët, përcakton qëllimin e vizitës së vizitorëve dhe i njofton zyrtarët përkatës të njësive lidhur me vizitorin;
- Monitoron hyrjen dhe daljen e vizitoreve dhe i pajis me leje kalime nëse kërkohet për qasje në ndërmarrje si dhe mbanë regjistrin për hyrjet dhe daljet;
- Pranon dhe regjistron postën zyrtare dhe adreson tek personat përkatës të Kompanisë;
- Kryen edhe detyra tjetër në përputhje me ligjet dhe rregulloret të cilat mund të kërkohen në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe nga mbikëqyrësi.

#### Kualifikimet dhe shkathtësitë e kërkuara:

- Të ketë shkollën e mesme ;
- Të prezantoj leternjoftimin;
- Çertifikatë nga gjykata se nuk jeni i denuar (më e re se 6 muaj);
- Shkathtësi në komunikim, me stafin brenda Kompanisë;
- Shkathtësi kompjuterike në aplikacione të programeve(Word, Exel); ose administrative.

#### Kushtet e veçanta:

Punëtori 6 (gjashtë) muajt e parë do të jetë në punë provuese, dhe varësisht nga performanca e tij do të vazhdohet apo përtrihet kontrata e punës.

Aplikacionin së bashku me diplomën, referencat etj. mundë të dorëzohen në Zyrën e Arkivës, në Kompaninë Regjionale të Mbeturinave "Uniteti" Sh.A. Mitrovicë. Konkursi do të jetë i hapur 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e publikimit në gazetën ditore prej 06.06.2020 deri më datën 20.06.2020. Kërkesat e dorëzuara pas afatit dhe të pakompletuara me dokumentacione përkatëse, nuk do të merren për shqyrtim nga ana e Komisionit Vlerësues. Vlerësimi formal dhe intervista do të bëhet pas përfundimit të afatit të aplikimit.

#### NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se "Balea" SH.P.K. ka marrë vendim të shuajë biznesin me numër: 811341859 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditorë - Debitorë në këtë Korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

#### OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "Balea" SH.P.K. donelo odluku o prestani rada sa bisnisom : 811341859 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

#### ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the "Balea" SH.P.K. has come to the decision to quit its business: 811341859 The company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

**Lume's Details**  
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Abrrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

#### >> SHPALLJE TË VOGLA <<

- ▶ "URBAN FM" sh.p.k, me seli në Prishtinë, shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me numër: 8100411880
- ▶ Jap banesë me qira afër 60 m2, kati III-Lagja Mati 1 Rr.Z3-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon . Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.
- ▶ Lëshoj banës me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.
- ▶ Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.
- ▶ Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.
- ▶ Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Urgjentisht kërkohet një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188
- ▶ Lëshoj lokalit më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollëshme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275
- ▶ Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139
- ▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.
- ▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.



## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

